

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5806  
E enjte, 20 qershor 2019  
çmimi 0.40 €

Bahtiri kërkon nga  
institucionet qendrore  
ndërprerjen e ndërtimeve  
ilegale në veri | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYETARI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), KADRI VESELI, PARALAJMËRIMIN SE NUK DO TË LEJOJË QË ASNJË PERSON ME AKTAKUZA PËR KORRUPSION TË MBAJË POZITA NË INSTITUCIONE DHE NË PDK, E KA KTHYER TË MËRKURËN NË VENDIM | FAQE 4-5

## Veseli liron nga detyra të gjithë zyrtarët e PDK-së me aktakuza



Pas zotimit për luftë kundër korrupsionit, lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka liruar nga detyra të gjithë të emëruarit politikë nga kjo parti që janë të akuzuar për korrupsion dhe nepotizëm. Po ashtu, Veseli ka liruar nga detyra edhe të zgjedhurit brenda strukturave drejtuese të PDK-së që kanë aktakuza të konfirmuara. Me këtë veprim, Veseli ka thënë se po vendos standard të ri në politikë. Shoqëria civile dhe njohësit e rrethanave politike kanë kërkuar që shembullin e Veselit ta ndjekin edhe subjektet e tjera politike në pozitë dhe opozitë

## Thaçi: Kosova po trajtohet padrejtësisht, konkluzionet për vizat janë zhgënjyese

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën është shprehur i pakënaqur me qasjen e Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës. Ai ka thënë se BE-ja është duke e trajtuar padrejtësisht Republikën e Kosovës. Sipas Thaçit, konkluzionet e Këshillit të Ministrave të BE-së për vizat janë zhgënjyese. Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka vlerësuar se përfundimet e Këshillit të Ministrave të BE-së për Kosovën nuk përmbushin pritjet e qytetarëve. Ajo ka thënë se Kosova ka pritur vlerësim objektiv për liberalizimin e vizave | FAQE 3



## ShSKUK-ja shënon përmirësime në raportin e auditimit për vitin 2018 | FAQE 3



### OPINION

#### KËMBËT DHE GISHTI I DIKTATORËVE!

F. 11

Bardhyl MAHMUTI



### AKTUALE

#### SHOQËRIA CIVILE PEZULLON PJESËMARRJEN NË KOMISIONIN PARLAMENTAR AD-HOC PËR PROCESIN ZGJEDHOR F. 7

#### BRITANIA KONFIRMON MBËSHTETJEN PËR FSK-në F. 5



### EKONOMI



#### NË MITROVICË PËRURORHET PROJEKTI 5.4 MILIONË EURO PËR ENERGJI STABILE F. 8

#### LANSOHET KAMPANJA 'VENDE TË SHËNDETSHME PUNE...' F. 9

### SPORT

#### RASHKAJ: KUALIFIKIMI NË EVROPIAN, I MUNDSHËM F. 18

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Rama ia heq pasaportën diplomatike Lulzim Bashës

TIRANË, 19 QERSHOR - Kryeministri Edi Rama ka urdhëruar zëvendësministrin Gent Cakaj për ta pezulluar pasaportën diplomatike të kreut të opozitës, Lulzim Basha. Pra, praktikisht lideri i opozitës shqiptare nuk ka pasaportë diplomatike, ndonëse i takon sipas ligjit në fuqi. Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj, e ka konfirmuar lajmin, duke e cilësuar një gjest të ulët. "Para tri ditësh iu hoq pasaporta

diplomatike Bashës. Heqja e pasaportës diplomatike të Bashës është hakmarje e ulët bizantine", deklaroi Lulzim Basha.

Heqja e pasaportës ka qëllim vetëm pengesa procedurale për udhëtimet e kreut të PD-së jashtë shtetit dhe synon një lloj izolimi në takimet me ndërkombëtarët. Skandali në këtë rast nuk lidhet me procedurat, por me gjestin e ulët të një qeverie. Denigrimi i kundërshtarit politik ka tejkaluar

çdo imagjinatë, duke arritur dhe në akte të tilla që tregojnë idiotësi shtetërore. Kreu i opozitës, kushdo qoftë ai, është përfaqësues i interesave të qytetarëve, por edhe në një farë mënyrë institucion i një republike normale. Shqipëria ka trafikantë që udhëtojnë me pasaporta diplomatike dhe shërbime, ndaj heqja e pasaportës së kreut të opozitës është vetëm dëshmi e një pushteti që po shkon drejt autokracisë.



## Zgjedhjet vendore tensionojnë situatën në Shqipëri

Në shumë qytete të Shqipërisë ku opozita ka kontrollin e bashkive të mërkurën ka pasur tensione të forta. Mbështetësit e saj u grumbulluan pranë mjediseve ku janë vendosur komisionet zonale të administrimit të zgjedhjeve, duke kërkuar ndërprerjen e procesit, me ç'rast policia ka përdorur gazin lotsjellës për t'i shpërndarë mbështetësit e opozitës



TIRANË, 19 QERSHOR - Çaste të forta tensioni ka pasur të mërkurën në shumë qytete të Shqipërisë ku opozita ka kontrollin e bashkive. Mbështetësit e saj janë grumbulluar pranë mjediseve ku janë vendosur komisionet zonale të administrimit të zgjedhjeve (KZAZ), duke kërkuar ndërprerjen e procesit. Situata ka kaluar në përballje me policinë në Kamëz dhe në Burrel, ku është tentuar hyrje në mjediset e KZAZ-ve. Mësohet se policia ka përdorur gazin lotsjellës për t'i shpërndarë mbështetësit e opoz-

itës, të cilët, megjithatë, kanë mundur që më vonë të hyjnë brenda Pallatit të Sportit duke nxjerrë prej andej dhe shkatërruar materialet zgjedhore, të cilave iu vu flaka. Drejtuesit e djathtë të bashkive prej ditësh po këmbëngulin në lirin e mjediseve të cilat janë vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për procesin e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit. Sipas të djathtëve, dekreti i presidentit Ilir Meta për anulimin e 30 qershorit duhet respektuar e, për pasojë, nuk

mund të ketë asnjë proces zgjedhor. Ndërkohë që KQZ-ja e ka konsideruar të pavlefshëm vendimin e kreut të Shtetit dhe ka vijuar me përgatitjet e zgjedhjeve. Tensione të forta u regjistruan të martën edhe në Tropojë, ku

mbështetësit e opozitës hynë brenda KZAZ-s në qendër të qytetit. Ndërsa në Shkodër përplasjet me policinë përfunduan mbrëmjen e së martës me thyerjen e xhamave në një shkollë të qytetit dhe vënien zjarr në

mjediset ku ndodheshin materialet zgjedhore të një prej KZAZ-ve të Shkodrës. Policia njoftoi të mërkurën se të paktën 13 persona janë arrestuar për ngjarjet e dhunshme të martën në Tropojë dhe Shkodër.

## Meta njofton ndërkombëtarët: Nuk i njoh zgjedhjet e 30 qershorit

TIRANË, 19 QERSHOR - Presidenti Ilir Meta ka njoftuar drejtuesit e lartë të OSBE/ODHIR lidhur me dekretin e tij për ç'dekretimin e datës zgjedhore të 30 qershorit. Në letërën që mban datën 19 qershor 2019 dërguar ministrit të Punëve të Jashtme dhe

Evropiane të Sllovakisë, Miroslav Lajqak, drejtoreshës së Zyrës së OSBE-së për institucionet demokratike, Ingibjorg Solrun Gisladdottir, presidenti Meta i njofton zyrtarët se nëse zgjedhjet do të mbahen në kundërshtim me dekretin do të jenë nul dhe të

pavlefshme. "Sipas legjislacionit në fuqi, dekreti nr. 1199 i datës 10. 06. 2019 është në fuqi dhe është i publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë më 11 qershor. Për këtë dekreti është ligjor dhe duhet të implementohet nga të

gjitha institucionet, përfshirë edhe administratën e procesit zgjedhor në Shqipëri, përfshirë edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për këtë arsye procesi zgjedhor që mund të mbahet në dhunim të dekretit të presidentit do të jetë nul dhe i pavlef-

shëm dhe përpjekjet e kryeministrit të Shqipërisë për të injoruar dhe bllokuar implementimin e dekretit të presidentit të republikës janë totalisht të paligjshme dhe do ta dëmtojnë krizën në Shqipëri", thuhet në letërën e presidentit Meta.

## Cakaj: Opozita, pengesë shtesë për çeljen e negociatave

Tiranë, 19 qershor - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, e cilësoi si një fitore të Shqipërisë që në raportin e Komisionit Evropian nuk është marrë parasysh situata aktuale në Shqipëri. Ai tha se në tetor BE-ja do të shkojë drejt një vendimi pozitiv për çeljen e negociatave me Shqipërinë, por sjellja e opozitës është një pengesë tjetër që do të çojë drejt

këtij vendimi. "Vendet anëtare të BE-së dënojnë sjelljen e grupimeve politike në Shqipëri, por nuk thonë se kjo sjellje do ta deprivojë Shqipërinë nga mundësia për hapjen e negociatave. Por natyrisht se klima aktuale politike në Shqipëri nuk iu kontribuon gjasave pozitive për hapjen e negociatave në tetor", theksoi Cakaj. I pyetur nëse mund të na kthehet

në penalizim situata aktuale politike në Shqipëri, Cakaj tha se nuk mund të përjashtohet. "Me rëndësi që vendet anëtare të jenë të ndërgjegjshme, që agenda progresive e Qeverisë së Shqipërisë do të vijojë pavarësisht situatës së brendshme dhe sabotimit politik të opozitës. Nëse kjo do të manifestohet, është një gjë që do ta shohim", tha Cakaj.





Në skenën politike ka vazhduar debati rreth konkluzioneve të Këshillit të Ministrave të BE-së për liberalizimin e vizave për Kosovën

# Thaçi: Kosova po trajtohet padrejtësisht, konkluzionet për vizat janë zhgënjyese

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën është shprehur i pakënaqur me qasjen e Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës. Ai ka thënë se BE-ja është duke e trajtuar padrejtësisht Republikën e Kosovës. Sipas Thaçit, konkluzionet e Këshillit të Ministrave të BE-së për vizat janë zhgënjyese. Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka vlerësuar se përfundimet e Këshillit të Ministrave të BE-së për Kosovën nuk përmbushin pritjet e qytetarëve. Ajo ka thënë se Kosova ka pritur vlerësim objektiv për liberalizimin e vizave



**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 19 QERSHOR** - Konkluzionet e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës nuk janë mirëpritur të mërkurën nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha.

Presidenti Thaçi i ka quajtur zhgënjyese këto konkluzione sepse, sipas tij, Kosova nuk është fajtorë për problemet e brendshme të BE-së. "Me shqetësim i kam lexuar konkluzionet zhgënjyese të Këshillit për Çështje të Përgjithshme të Bashkimit Evropian. Shihet qartë që turbulencat e brendshme e kanë turbulluar vizionin e BE-së, e cila nuk po arrin ta tejkalojë instinktin proteksionist dhe neglizhencës ndaj tërë rajonit, e posaçërisht Kosovës. Ne nuk jemi fajtorë për problemet e brendshme të BE-së, as që paraqesim asnjë rrezik për BE-në. Prandaj, ne nuk do të mund të cilësohemi si fajtorë për zvogëlimin e rolit të BE-së në rajon dhe në Kosovë për shkak të dështimeve të vazhdueshme të saj. Përderisa shtetet fqinje, si Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, kanë pritur lajme substanciale në rrugën e tyre për anëtarësim në BE, ne kemi pritur diçka krejt minimale", është shprehur Thaçi.

Ai ka thënë se Kosova ka pritur reflektim pozitiv për vizat por, sipas Thaçit, BE-ja është duke e trajtuar Kosovën ndryshe

krahasuar me vendet e tjera. "Ne kemi pritur vetëm një reflektim pozitiv sa i përket fundit të izolimit të padrejtë të popullit të Kosovës. Fatkeqësisht, BE-ja është duke e trajtuar Kosovën ndryshe krahasuar me vendet e tjera dhe kjo padrejtësi nuk kalon pa u vërejtur. Por, nuk kalon pa u vërejtur as mungesa e një përkushtimi konstruktiv i institucioneve tona shtetërore për koordinimin e veprimeve strategjike në interes të vendit", ka deklaruar presidenti.

Kryetari i shtetit u ka bërë thirrje institucioneve dhe partive politike parlamentare që të reflektojnë për situatën në të cilën ndodhet Kosova në raport me realizimin e perspektivës për anëtarësim në BE dhe NATO. Thaçi ka thënë se izolimi dhe stagnimi duhet të marrin fund. "Unë ftoj liderët institucionale dhe ata të partive politike parlamentare që të reflektojnë për situatën e rëndë në të cilën ndodhet vendi ynë në raport me realizimin e perspektivës sonë për anëtarësim në BE dhe NATO. Izolimi dhe stagnimi duhet të marrin fund. Qytetarët e Republikës së Kosovës e meritojnë zhvillimin dhe integritetin e Kosovës në strukturat euroatlantike", ka shkruar presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka vlerësuar se përfundimet e Këshillit të Ministrave të BE-së për Kosovën nuk përmbushin pritjet e qytetarëve. Ajo ka thënë se Kosova ka pritur vlerësim objektiv për liberalizimin e vizave.

"Përfundimet e Këshillit të Ministrave të BE-së për Kosovën nuk përmbushin pritjet e qytetarëve tanë sepse nuk jep afate kohore dhe qëndrime të qarta ngaqë bëhet fjalë për disa nga 14 pikat të cilat janë sfida dhe kërkojnë veprim të vazhdueshëm. Ne kemi pritur dhe duam vlerësim objektiv për liberalizimin e vizave, udhërrëfyes i cili tashmë është vlerësuar për përmbushjen e të gjitha kriterëve për liberalizim", është shprehur Hoxha. Ministrja Hoxha ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", se shteti i Kosovës ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizim prandaj, sipas saj, ky proces duhet të përshpejtohet në mënyrë që izolimi të marrë fund. "Rëndësia e liberalizimit të vizave nuk përbën vetëm të drejtë themelore për qytetarët tanë, por edhe ndjenjë të përkatësisë dhe orientimit tonë jetik brenda vlerave evropiane. Ndryshe Evropa po risjell mundësitë e shfaqjes së prapaktimit të vlerave të

arritura bashkërisht sa të padëshirueshme për ne, aq edhe kërcënuese nga drejtimit jashtë vendeve të BE-së. Vendi ynë ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizim, andaj ky shqyrtim i serishëm i liberalizimit në Këshill nuk presim të jetë as pezullues dhe as frenues për të arriturat tona. Prandaj, kërkojmë që të përshpejtohet ky proces, sepse qytetarët tanë po vazhdojnë të jenë të vetmit të izoluar në Evropë", ka deklaruar ministrja Hoxha. Por ndryshe i sheh kryeministri Ramush Haradinaj konkluzionet e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian (BE). Një ditë më parë ai e ka quajtur sukses për Kosovën përfshirjen e çështjes së liberalizimit të vizave në konkluzionet e këtij Këshilli. Haradinaj ka vlerësuar se këto konkluzione nuk e kanë zbehur procesin e liberalizimit të vizave, por e kanë avancuar. Madje, sipas kryeministrit Haradinajt, po afrohet dita kur Kosova do ta marrë liberalizimin e vizave. "Deri më tani nuk

ka qenë duke u konsideruar marrja e vendimit nga Këshilli. Është hera e parë që kemi mbërritur deri te konkluzionet, pra jo që nuk është zbehur, por po afrohet dita kur do ta marrim lajmin e shumëpritur. Po punojmë për atë", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë me gazetarë pas mbledhjes së rregullt të kabinetit qeveritar. Ai ka thënë se po interpretohen gabimisht konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian në lidhje me liberalizimin e vizave. Megjithatë, Haradinaj ka theksuar se nuk ka ende vendime për liberalizimin e vizave, as kriteret shtesë, por ka vetëm disa konkluzione. Ai ka thënë se asnjëherë deri më tani Kosova nuk është përmendur në konkluzionet e Këshillit të BE-së për çështjen e vizave. Haradinaj ka shtuar se nuk ka qenë e lehtë hyrja e Kosovës në këto konkluzione. "Pra, ka qenë bukur punë për të ardhur deri aty, mirëpo mendoj se për të ardhur deri këtu ka ndihmuar sidomos Berlioni", ka theksuar Haradinaj.

## ShSKUK-ja shënon përmirësime në raportin e auditimit për vitin 2018

**PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER)** - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), sipas raportit zyrtar të auditimit të vitit 2018 të

nxjerrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ka shënuar përmirësim në zbatimin e rekomandimeve të dhëna për vitin 2017. Sipas raportit të vitit 2018,

nga 19 rekomandimet e dhëna për vitin 2017, ShSKUK-ja ka zbatuar dhjetë rekomandime apo 52 për qind të rekomandimeve të përgjithshme.

Tetë rekomandime të tjera janë në fazë të zbatimit gjatë vitit 2019, përderisa me buxhetin e vitit 2020 do të zbatohet edhe rekomandimi i fundit.





Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, paralajmërimin se nuk do të lejojë që asnjë person me

# Veseli liron nga detyra të gjithë



Pas zotimit për luftë kundër korrupsionit, lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka liruar nga detyra të gjithë të emëruarit politikë nga kjo parti që janë të akuzuar për korrupsion dhe nepotizëm. Po ashtu, Veseli ka liruar nga detyra edhe të zgjedhurit brenda strukturave drejtuese të PDK-së që kanë aktakuza të konfirmuara. Me këtë veprim, Veseli ka thënë se po vendos standard të ri në politikë. Shoqëria civile dhe njohësit e rrethanave politike kanë kërkuar që shembullin e Veselit ta ndjekin edhe subjektet e tjera politike në pozitë dhe opozitë

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 19 QERSHOR** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka larguar të mërkurën nga pozitë institucionale dhe partiake të gjithë zyrtarët e PDK-së që kanë aktakuza të konfirmuara nga

institucionet e drejtësisë. Në një konferencë për medie, lideri i PDK-së ka bërë me dije se me këtë vendim janë liruar nga detyra ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, zëvendësministri i FSK-së, Agim Çeku dhe Nijazi Kryeziu, të cilët janë në procese gjyqësore. "Në mandatin e ri si

kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës kam përcaktuar prioritetet tona themelore - si parti moderne me profil demokratik dhe perëndimor. Në fillim të kësaj jave unë jam zotuar se do të angazhohem fuqishëm në luftën kundër korrupsionit, nepotizmit dhe dukurive të neveritshme të abuzimit. Këtë

po e presin qytetarët nga ne, sepse ata janë të ngopur me fjalë dhe duan të shohin veprime konkrete. Nuk ka opSION tjetër përveçse të veprimje", ka thënë Veseli, duke shtuar se më këtë veprim po vendos standard të ri në politikë. "Ne po vendosim një standard të ri të etikës. Së pari po fillojmë me veten, pastaj këtë standard do ta shtrijmë në çdo segment. Sot, jam para jush, për të dëshmuar se jemi të vendosur në këtë betejë. Duke treguar përkushtimin tim dhe vizionin si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, kam vendosur që: Të emëruarit politikë nga radhët e PDK-së në institucionet publike të Kosovës, të cilët kanë aktakuza që ndërlidhen me

dyshime për keqpërdorim të pozitës zyrtare, korrupsion, ose nepotizëm, t'i lirojnë funksionet menjëherë", ka thënë Veseli.

Po ashtu, kreu i PDK-së ka konfirmuar se partia që drejton nuk do të kandidojë e as nuk do t'i mbështesë kandidatët e asnjë subjekti politik që kanë aktakuza të konfirmuara. "PDK-ja nuk do të kandidojë persona të cilët kanë aktakuza që ndërlidhen me dyshime për keqpërdorim të pozitës zyrtare, korrupsion, ose nepotizëm, në asnjë pozitë publike. Dhe, as nuk do t'i mbështesë kandidatët e tillë që mund të propozohen nga partitë e tjera ose qytetarët", ka deklaruar.

Lideri i PDK-së ka liruar nga



aktakuza për korrupsion të mbajë pozita në institucione dhe në PDK, e ka kthyer të mërkurën në vendim

# zyrtarët e PDK-së me aktakuza

pakompromis ndaj korrupsionit dhe nepotizmit. "E vetmja mënyrë për të siguruar mundësi të barabarta dhe shpresë për një të ardhme më të mirë për gjeneratën e ardhshme të të rinjve është ta bëjmë një luftë pa kompromis kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Dhe, do ta përmbushim vizionin tonë për Kosovën me mundësi të barabarta për të gjithë, ekonomikisht të fortë dhe pa korrupsion", ka deklaruar Veseli.

**Analistët thonë se shembullin e Veselit ta ndjekin edhe partitë e tjera**

Veprimi i kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, është përshëndetur nga shoqëria civile dhe njohësit e rrethanave politike në vend. Ata kanë kërkuar që edhe subjektet e tjera politike ta ndjekin shembullin e liderit të PDK-së. "Ky është një veprim i qëlluar dhe duhet përshëndetur. Kadri Veseli këtë veprim është dashur ta bëjë edhe më herët, mirëpo meqenëse ka qenë në zgjedhjet e brendshme, ai sigurisht se ka pritur se si po rrjedhin ngjarjet në Konventën Zgjedhore dhe pas marrjes së mandatit të ri ka larguar të gjithë ata që kanë akuza të konfirmuara. Një gjë të tillë prej partive e kanë kërkuar edhe ndërkombëtarët. Ndryshe nuk ka pasur kuptim ta udhëheqësh një parti me një numër të madh të të akuzuarve, sepse nuk mund të thirren se po luftojnë korrupsionin dhe, në anën tjetër, të keni zyrtarë të partisë me akuza nëpër institucione", ka thënë për gazetën "Epoka e re" analisti Behxhet Shala. Ai ka vlerësuar se me këtë veprim kjo parti po bën një kthesë të re, duke shtuar se lidhshimi i PDK-së duhet ta vazhdojë edhe në nivele të tjera procesin e dekriminalizimit. Sipas tij, nuk ka asnjë kuptim të jesh bartës i një institucioni publik derisa ke aktakuzë të konfirmuar. "Një veprim i tillë duhet të përkrahët dhe përshëndetet, pavarësisht se cila parti politike ka marrë vendim. Mendoj se edhe subjektet e tjera politike duhet ta ndjekin shembullin e z. Veseli, duke i larguar zyrtarët e tyre nga pozitave publike dhe parti-ake, sepse nuk ka mundësi tjetër. Ose duhet të largohen nga institucionet ata që janë në kundërshtim me ligjin ose t'u japim fund ambicieve për shtetndërtim dhe për krijimin e një shoqërie demokratike", ka thënë Shala. Si hap të mirë veprimin e Veselit

e ka parë edhe analisti tjetër politik, Imer Mushkolaj. "Veprimi i sotëm i Veselit është mesazh i mirë, por nuk do ta dekriminalizojë PDK-në. Korrupsioni dhe krimi janë postulate mbi të cilat është krijuar PDK-ja, por edhe disa parti të tjera në Kosovë. Nuk ka asgjë të jashtëzakonshme në veprimin e Veselit. Ai po përpiket të tregojë se është i fortë tash, pas rizgjedhjes kryetar i partisë, por me këta zyrtarë ai ka qeverisur dhe bashkëpunuar tash sa vite", ka thënë Mushkolaj për "Epokën e re".

Ndërsa Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka vlerësuar se ky duhet të jetë standard i ri i qeverisjes në Kosovë. "Kërkesa e Institutit të Kosovës për Drejtësi për qeveri me duar të pastra ka filluar të jetësohet. Vendimi i kryetarit të PDK-së, z. Kadri Veseli, është fillim i mirë dhe jep shpresë. Personat me aktakuza dhe që kanë probleme me ligjin nuk kanë vend në institucione publike dhe se paku në një parti politike. Së paku kështu u premtua. Le të shpresojmë se ky do të jetë standard i ri i qeveris-

jes në Kosovë", ka vlerësuar Miftaraj, duke shtuar se këtë qasje duhet ta ndjekin edhe partnerët e tjerë të koalicionit qeverisës. "Qasja e tillë duhet të ndiqet edhe nga kryeministri Haradinaj me ministrat nga AAK-ja, Fatmir Limaj në Nisma dhe partitë që janë në pushtet dhe opozitë, jo vetëm në nivel qendror, por edhe në atë lokal. Një shtet që aspron vlerat e Bashkimit Evropian nuk mund dhe nuk duhet të lejojë që të qeveriset me njerëz që kanë probleme me ligjin", ka thënë thënë Miftaraj.

## Britania konfirmon mbështetjen për FSK-në

**PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER)** - Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, dhe komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneraljeftënant Rrahman Rama, kanë pritur të mërkurën në takim të ndara drejtorin e Departamentit për Siguri Euro-Atlantike nga Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar, Nick Gurr, të shoqëruar edhe nga ambasadori britanik Rruari O'Connell, atashu i Mbrojtjes, nënkoloneli Andy Layton dhe këshilltari britanik i komandantit të FSK-së, nënkoloneli Jake White. Në të dy takimet u bisedua për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e deritanishëm si dhe perspektivën e këtyre marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, respektivisht ministrive të Mbrojtjes të dy vendeve tona. Ministri Berisha ka theksuar mbështetjen e vazhdueshme në fushën e mbrojtjes të Britanisë së Madhe si partnere strategjike

e rëndësisë së veçantë për Republikën e Kosovës. Berisha e ka falënderuar Gurrin edhe për përkrahjen politike të Britanisë së Madhe në procesin para dhe gjatë transformimit të FSK-së në forcë me mision ushtarak, duke iu referuar në veçanti deklaratës së qartë të ambasadores së Britanisë së Madhe në Këshillin e Sigurimit: "Kosova, si shtet i pavarur, ka të drejtë t'i ndërtojë forcat e veta të armatosura", ka thënë Berisha. Ai më pas e ka njoftuar Gurrin me ecurinë e zbatimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së dhe rezultatet konkrete gjatë fazës së parë 120 ditëshe, pas hyrjes në fuqi të ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Ministri Berisha ka theksuar se plani gjithëpërfshirës i tranzicionit të FSK-së është përgatitur në bashkëpunim me partnerët dhe zbatohet në mënyrë transparente. Ai ka shtuar se zbatimi i këtij plani është gradual, gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm dhe ndahet në tri faza. Duke u

bazuar në marrëdhëniet e shkëlqyeshme dypalëshe dhe rolin e Britanisë së Madhe në storien e përbashkët të suksesit, ministri Berisha ka kërkuar që përkrahja britanike të shtohet edhe më tej duke reflektuar nevojat e FSK-së me mision të ri. Në adresimin e tij, drejtori i Departamentit për Siguri Euro-Atlantike nga Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar, Nick Gurr, ka uruar popullin e Kosovës për 20-vjetorin e hyrjes së trupave të KFOR-it. Ai e siguroi ministrin Gashi që edhe pas BREXIT-it, rajoni i Ballkanit dhe Kosova në veçanti do ta ketë vëmendjen e Britanisë së Madhe. Gurr ka pohuar se Britania e Madhe do të jetë edhe më e angazhuar duke qenë zë i fuqishëm i Kosovës në qëllimin e saj për anëtarësim në NATO. Ai ka theksuar se do ta thellojnë bashkëpunimin bilateral në fushën e mbrojtjes dhe do ta vazhdojnë përkrahjen në tranzicionin e FSK-së.



detyra edhe të gjithë të zgjedhurit brenda strukturave drejtuese të PDK-së që kanë aktakuza të konfirmuara. Ai ka treguar se pezullim i funksioneve të tyre vlen deri në aktgjykime. "Ky vendim nuk e paragjykon fajësinë e tyre dhe me përfundimin e gjykimeve, kur ato janë liruese, të gjithë këta persona do të kenë vendin e merituar në PDK dhe në institucione. Prandaj, unë kam biseduar me zyrtarët tanë partiakë që kanë aktakuza dhe i kam njoftuar ata për lirimin nga detyrat zyrtare që kanë mbajtur", është shprehur Veseli. I pari i PDK-së ka thënë se nepotizmi dhe korrupsioni janë rritur në vendin dhe kjo duhet të ndryshojë me një luftë të



## Apostolova kritikon monopolin e homologimit, thotë se qytetarët e Kosovës po paguajnë më së shumti


PRISHTINË, 19 QERSHOR - Anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik kanë diskutuar të mërkurën me shefen e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave, barrierat jtarifore për importin e veturave të reja që kanë origjinën nga BE-ja. Kryetarja e këtij komisioni, Sala Berisha-Shala, ka thënë se personalisht ka marrë një letër për një shqetësim në këtë drejtim dhe,

sipas saj, në dy mbledhjet e kaluara kanë diskutuar si komision për homologimin. Shefja e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka theksuar nevojën e konkurrencës në secilin treg dhe dëmin që po u bëhet qytetarëve nga monopoli. "Konkurrenca është një nga elementet themelore të tregut të lirë dhe është një fushë ku Kosova duhet ta përmirësojë vetën. Është temë e pashmangshme pasi sjell të mira. Homologimi i veturave

është çështje që Zyra e BE-së e ka ngritur si çështje tash e disa vjet. Na e kemi diskutuar me ministrinë, kryeministrinë. Ne kemi frikë se mund të ketë zgjatje të kontratës me operatorin ekonomik 'EuroLab'. Tanimë qytetarët po paguajnë çmime më të larta që jepen veç në Prishtinë dhe të cilat nuk janë të sfiduara nga kompanitë e tjera dhe çmimi është më i larti në rajon", ka thënë Apostolova.



## Presidenti Thaçi liron nga detyra këshilltarin politik Branislav Nikoliq



PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka liruar nga detyra këshilltarin politik Branislav Nikoliq. Zyra e presidentit e Republikës së Kosovës nëpërmjet një deklaratë për medie ka konfirmuar se nuk ka pasur asnjë informacion paraprak dhe zyrtar nga institucionet e sigurisë në Kosovë për përfshirjen e mundshme të Branislav Nikoliqit në aktivitete të dyshimta për të cilat është raportuar në media. "Përkundër kësaj, Zyra e

Presidentit i merr seriozisht raportimet e medieve për përfshirjen e mundshme të z. Nikoliq në aktivitete të dyshimta, qofshin ato të natyrës kriminale ose që cenojnë sigurinë kombëtare. Nisur nga parimi i respektimit të ligjit dhe për t'u dhënë hapësirë autoriteteve të sigurisë që të kryejnë hetime të pavarura për këtë rast, presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, ka liruar sot nga detyra e këshilltarit poli-

tik, z. Branislav Nikoliq", është thënë në deklaratën e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.

Presidenti Thaçi mbetet i përkushtuar për avancimin e të drejtave të komuniteteve joshqiptare dhe përfundimin e tyre në të gjitha nivelet e qeverisë qendrore dhe lokale, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Rasti konkret është thjesht çështje e sundimit të rendit dhe ligjit", është theksuar më tutje në këtë deklaratë.

## IKD-ja: Qeveria ta anulojë vendimin e kundërligjshëm për ndarjen e 95 000 eurove

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar ndaj vendimit nr. 10/104 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 23 maj 2019, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 95 000 eurosh për hartimin e akteve nënligjore dhe përgatitjet e nevojshme për zbatimin e Ligjeve për Reformën e Administratës Publike. "Vendimi i lartpërmendur cenon rëndë parimet e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Nga analiza e IKD-së lidhur me vendimin e lartpërmendur rezultojnë se Qeveria e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me këto parime, duke miratuar një vendim që është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë, duke dhënë kompensim



shtesë për një kategori të caktuar të shërbyesve civilë për të kryer detyra dhe përgjegjësi të cilat i kanë të përcaktuara në ligj dhe

kontratën e punës. Për më tepër, lista e personave që përfitojnë nga një vendim i tillë i qeverisë janë kryesisht pozita të larta në

shërbimin civil, ku shumica kanë pozitën e drejtorëve apo udhëheqësve të divizioneve apo zyrave të tjera në Zyrën e Kryeministrit apo ministrive të caktuara", është thënë në reagimin e IKD-së. Sipas këtij instituti, vendimi i qeverisë është në kundërshtim së paku me dy ligje, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. "Mosreagimi i qeverisë dhe mosanulimi i këtij vendimi do të ketë pasoja juridike që hyn në kuadër të sferës penale, respektivisht shkeljes së dispozitave të Kodit Penal të Kosovës dhe Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik", është thënë në këtë reagim.

IKD-ja ka kërkuar nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe kabineti qeveritar që të reflektojë, duke e anuluar vendimin nr. 10/2014 të datës 23 maj 2019. Për më shumë lidhur me këtë kërkesë, IKD-ja i është drejtuar me letër zyrtare kryeministrit Haradinaj dhe ministrave të qeverisë që të reflektojnë mbi këtë vendim të kundërligjshëm, duke e anuluar. "Nëse kryeministri Haradinaj dhe kabineti qeveritar nuk reflektojnë, ftohen organet e ndjekjes që t'i zbatojnë obligimet ligjore në drejtim të hetimit të këtij vendimi dhe përfitimeve të kundërligjshme prej tij. Gjeni të bashkangjitur edhe letrën e dërguar kryeministrit Haradinaj dhe kabinetit qeveritar", është theksuar në reagimin e IKD-së.

## Kryesia e LDK-së përkujton veprimtaren Nekibe Kelmendi

Prishtinë, 19 qershor (ER) - Anëtarë të kryesisë, deputetë, zyrtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe familjarë kanë bërë homazhe të mërkurën te varri i nënkryetares së LDK-së, Nekibe Kelmendi. Në tetëvjetorin e vdekjes, për veprimtarinë e saj në emër të kryesisë ka folur sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ismet Beqiri. Ai ka vlerësuar

me admirim gjithë veprimtarinë e saj politike dhe atdhetare duke e cilësuar si zonjë të hekurt. "Nekibja ishte nënkryetare e LDK-së, deputete e jona dhe ministre e cila, përveç gjithë kontributit të saj në shërbim dhe ndërtim të shtetit të Kosovës, këtij vendi ia dha edhe burrin dhe dy djemtë. Ishte shembull i punës dhe përkushtimit për

LDK-në, Kosovën dhe qytetarët e saj. Familja Kelmendi iu përkushtua lirisë, pavarësisë dhe ndërtimit të shtetit tonë. Ndihet mungesë e saj jo vetëm në LDK, por edhe në të gjitha institucionet tona", ka thënë Beqiri. Nekibe Kelmendi ndërroi jetë më 19 qershor 2011, pas një sëmundje të shkurtër.





# Bahtiri kërkon nga institucionet qendrore ndërprerjen e ndërtimeve ilegale në veri

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i ka bërë thirrje presidentit, qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës të ndërmarrin veprime të nevojshme për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale në veri

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

MITROVICË, 19 QERSHOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të mërkurën ka pranuar një petition me rreth 115 nënshkrime nga qytetarët e lagjes "Kroi i Vitakut" nga qyteti i Mitrovicës, të cilët kanë shprehur shqetësimet dhe pakënaqësitë e tyre lidhur me ndërtimin e banesave kolektive të destinuara për pjesëtarët e komunitetit serb. Me këtë rast, kryetari Bahtiri, duke u solidarizuar me qytetarët e kësaj

lagjeje, kërkon nga presidenti, qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme duke u bazuar në kompetencat e tyre, për ndërprerjen e këtyre ndërtimeve të paligjshme dhe ilegale.

Kryetari Bahtiri ka theksuar se iniciativa të tilla janë diskriminuese ndaj popullatës shqiptare në atë pjesë të qytetit, duke marrë parasysh edhe faktin që nga pjesa veriore e Mitrovicës janë zhvendosur mbi 15 mijë shqiptarë, ku shumica prej tyre edhe sot e kësaj dite nuk kanë mundur të



kthehen në pronat e tyre. "Në lidhje me këtë shqetësim të qytetarëve të 'Kroit të Vitakut', ne si qeverisje lokale mbështesim shqetësimin e ngritur nga

këta banorë duke iu drejtuar organeve kompetente të nivelit qendror për ndërprerjen e këtyre ndërtimeve", ka thënë Bahtiri. Ai shpreson se zëri i

ngritur i këtyre qytetarëve, i shprehur përmes këtij peticioni, të merret parasysh dhe kërkesa të realizohet sa më parë.

## Shoqëria civile pezullon pjesëmarrjen në Komisionin Parlamentar Ad-hoc për procesin zgjedhor

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 QERSHOR - "Duke pasur parasysh zhvillimet e fundit në lidhje me Projektligjin për Financimin e Subjekteve Politike, ne, organizatat e shoqërisë civile, anëtarë në grupin këshillëdhënës të themeluar nga Komisioni Parlamentar Ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, në të cilin marrin pjesë kryetarët e grupeve parlamentare, dëshirojmë të bëjmë të ditur për opinionin publik dhe të gjithë aktorët relevantë të përfshirë në këtë proces, se do

ta pezullojmë pjesëmarrjen tonë në grupin këshillëdhënës deri në tërheqjen e këtij projektligji", është thënë në reagimin e shoqërisë civile.

Shoqëria civile ka vlerësuar se projektligji aktual është në kundërshtim me frymën kushtetuese dhe reformën zgjedhore të iniciuar nga Kuvendi i Kosovës. "Projektligji degradon parimet kryesore të jetës politike duke rrezikuar integritetin e tërë procesit të reformës zgjedhore, përfshirë edhe cenimin e pavarësisë së Zyrës për Regjistrimin e Subjekteve Politike. Projektligji aktual dështon në adresimin e

prioriteteve të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) për transparencë, llogaridhënie, zbatim dhe sanksionim efikas në financimin e partive politike, duke u mundësuar subjekteve politike ta fshehin identitetin e kontribuuesve financiarë të tyre, duke ngritur shumëfish lartësitë e këtyre kontributeve, duke ua zgjatur afatet për publikimin e raporteve financiare të fushatës dhe duke i zvogëluar gjobat, në rastet kur partitë e shkelin ligjin", është thënë në këtë reagim. "Meqenëse Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike nuk mund

të shihet si pjesë e ndarë e reformës zgjedhore dhe i njëjti rrezikon këtë proces, kërkojmë që projektligji të tërhiqet apo të mos votohet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Komisioni Ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor është formuar në prill të këtij viti dhe ka si synim kryesor adresimin e rekomandimeve të vëzhguesve të zgjedhjeve nga BE-ja. Në këtë komision, përveç përfaqësuesve të subjekteve politike, marrin pjesë edhe organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë ndihmuar vazhdimisht institucionet vendore në ndër-

timin e kapaciteteve për administrim dhe monitorim të procesit zgjedhor", thuhet në reagimin e organizatave të shoqërisë civile.

Ky aktivitet mbështetet nga 100 organizata të shoqërisë civile. Organizatat anëtare në grupin këshillëdhënës të themeluar nga Komisioni Parlamentar Ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor janë: Demokracia në Veprim/ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Demokracia për Zhvillim (D4D), Demokracia Plus (D+), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar.





## Në Mitrovicë përrurohet projekti 5.4 milionë euro për energji stabile

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të mërkurën në përrurimin e projektit "Ndërtimi i nënstacionit 110/10 (20) kV Ilirida dhe linjës nëntokësore transmetuese 110 kV" në Mitrovicë, me ç'rast ka thënë se nga sot kjo komunë është lidere në përvetësimin e teknologjisë më të re në energji. "Sa mirë të bashkohemi në Mitrovicë për një vepër ekonomike, një vepër në energji, kur jemi të vetëdijshëm të gjithë sa e rëndësishme dhe sa vitale është energjia jo vetëm për jetën, për ekonominë, por edhe për sigurinë", ka thënë Haradinaj me rastin e përrurimit të projektit prej 5.4 milionë eurosh "Ndërtimi i nënstacionit 110/10 (20) kV Ilirida dhe linjës nëntokësore transmetuese 110 kV", në Mitrovicë. Ai ka deklaruar se kjo vepër i dedikohet energjisë, shërbimit me energji për konsumatorë, një vepër që ka munguar, por që e rregullon dhe stabilizon gjendjen e furnizimit me energji për 50 vjetet e ardhshëm.

Duke falënderuar drejtorin e BERZh-it për Kosovë, Haradinaj ka theksuar se ky është një partneritet, kredi e butë, partneritet mes KOSTT-it dhe BERZh-it për këto investime në Mitrovicë, në Drenas dhe investime të tjera në

nivel vendi. "Energjia është me rëndësi për jetën në radhë të parë, për konsumatorët qofshin ata në jug apo në veri, apo në cilëndo anë të këtij nënstacioni. Është me rëndësi për ekonominë në tërësi, por edhe për sigurinë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se energjia është një prej fushave të veprimtarisë ekonomike që i kushtohet rëndësi në nivel global, sepse ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në siguri dhe kështu vendet që avancojnë në infrastrukturë dhe në energji janë vende stabile.

Më tej kryeministri Haradinaj ka pohuar se çdo vend që është stabil është kontribut që ndihmon në stabilitetin e të tjerëve, ndërsa një vend që nuk është stabil në energji për vetveten mund të kthehet në problem për gjithë të tjerët dhe mund të shkaktojë vështirësi dhe çrregullime. "Kosova i ka të gjithë parametrat me qenë vend stabil në energji, me pas prodhim të qëndrueshëm të energjisë dhe për këtë arsye projekti i Kosovës së Re, investimi në termocentralin e ri, është jetik për Kosovën, sepse ne jemi të bazuar për energji të qëndrueshme në thëngjill", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Kosova i ka hapur perspektivë energjisë së ripërritshme dhe së shpejti në këtë rajon do të ketë një projekt shumë të rëndësishëm të investimit në energji të ripërritshme dhe nuk



do të ndalemi. "Nuk mund ta lëmë Kosovën pa burim të qëndrueshëm të prodhimit të energjisë, në këtë rast pa 'Kosovën e Re' dhe do të punojmë së bashku që ta realizojmë", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se të gjithë jemi njerëz të kësaj toke dhe në Kosovë të gjithë janë në shtëpinë e tyre, shqiptarët shumicë, serbë, komunitete të tjera. Por, siç tha kryeministri, "ekzistojnë rregulla për të gjithë, pa dallim, në gjithë botën, jo vetëm për shqiptarët, jo vetëm për serbët, amerikanët, gjermanët, produktet që i merr i paguan, pra është në interesin e të gjithëve që të paguhen produktet që i merr

konsumatori, është në interesin e të gjithëve që të vendoset rregull në treg, në këtë rast të paguhen faturat e energjisë elektrike në veri, të paguhet uji, mbeturinat". "Janë detyra elementare të qytetarëve dhe shoqërive normale. Askush nuk do të fitojë nga një çrregullim në treg dhe ne e kërkojmë të drejtën tonë si Kosovë, të vendosim rregull në tregun e energjisë, ta japim kontributin tonë në tregun rajonal, por edhe të jemi anëtar i barabartë jo vetëm i transmetuesve të lartë, por të jemi të barabartë me të gjithë partnerët në energji. Kjo është legjitime dhe shpresoj në përkrahjen e gjithë partnerëve",

ka thënë kryeministri Haradinaj, duke falënderuar ShBA-në dhe Gjermaninë për një kujdes të vazhdueshëm për temat që kanë të bëjnë me tregun e energjisë, rregullimin e tij dhe përkrahjen që japin institucionet tona, në këtë rast KOSTT-i, ZRRE, KEK, por edhe KEDS-i dhe gjithë aktorëve. Nga një fjalë mbajtën kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri dhe kryeshefi i KOSTT-it, Ilir Shala. Një nënstacion i tillë të mërkurën është përruruar edhe në Komunën e Drenasit, investim prej 6.7 milionë eurosh. Nënstacionet janë ndërtuar duke përdorur teknologjinë më moderne GIS.

## Takohen komisionet teknike për transport tokësor Kosovë - Shqipëri: Masa rigoroze për shkelësit e marrëveshjeve



PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Të mërkurën në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit janë takuar komisionet teknike për transport tokësor të Kosovës dhe Shqipërisë për të diskutuar rreth respektimit të licencave nga kompanitë për transportin e udhëtarëve. Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, udhëheqës i këtij takimi, ka njoftuar palën shqiptare lidhur me shkeljen e masave nga operatorët nga Shqipëria që janë të licencuar për transport transit nëpër Kosovë

dhe ka përcjell mesazhin e Qeverisë së Kosovës dhe të ministrit Pal Lekaj, që qarkullimi i lirë të mos pengohet, por të respektohen rregullat dhe marrëveshjet e nënshkruara në këtë fushë. Kadriu dhe prijësi i delegacionit nga Shqipëria, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, Artan Shkreli, u pajtuan për marrjen e masave rigoroze drejt ndërgjegjësimit të operatorëve që i shkelin rregullat dhe marrëveshjet bilaterale mbi transportin e udhëtarëve. Më tutje, të dy delegacionet u paj-

tuan që në të ardhmen të ketë harmonizim edhe më të mirë të akteve legjislative në këtë fushë, që të mos ketë pengesa në operimin e transportit të udhëtarëve, qoftë në linjat transite apo ato ndërkom-bëtare. Ky takim u organizua në mënyrë të menjëhershme, pas vendimit të MIT-së për t'i ndaluar dy operatorët të Shqipërisë, pas shkeljes së lejes për të qarkulluar nga Tirana në Bajram Curr përmes Kosovës vetëm transit, por që këta kanë ndaluar të marrin udhëtarë, duke u shkakuar dëme operatorëve vendës.

## Vala vjen me dy pako të reja të internetit

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Shefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka bërë me dije se për këtë sezon veror kanë lansuar dy pako të reja të internetit. "Ky sezon veror do të jetë edhe më i volitshëm për të gjitha grupmoshat e konsumatorëve tanë, sidomos për bashkatdhetarët, por edhe për pushuesit që do ta përzgjedhin bregdetin shqiptar. Kjo për arsye

se të gjithë ata që dëshirojnë t'u besojnë shërbimeve të Valës do të përfitojnë oferta tejet atraktive në këtë sezon turistik", ka thënë Istrefi të mërkurën. Ai ka theksuar se Telekom i Kosovës si çdoherë tjetër do të vazhdojë të jetë sa më afër bashkatdhetarëve, por edhe të gjithë konsumatorëve duke iu ofruar produkte cilësore dhe

internet të shpejtë. "Këtë verë për konsumatorët tanë ne ofrojmë pakon 'Diaspora', e cila mund të blihet lehtësisht, vetëm duke dërguar një sms, çmimi i së cilës sillet nga 3.00, 5.00, 10.00 dhe 15.00 euro, duke filluar nga 2 deri në 15 GB. E veçanta e këtyre pakove është se ato përmbajnë edhe internet në bregdetin shqiptar", ka thënë Istrefi. Ai ka shtuar se këto

pako mund të shfrytëzohen duke zgjedhur edhe operatorët e telefonisë mobile në Shqipëri. "Që të shijosh sa më mirë aventurën tënde verore në Shqipëri, zgjidh një nga pakot Alb të Valës duke përfituar tarifat më të favorshme të roamingut. Risi këtë verë është se pakot mund t'i shfry-

| Për bashkatdhetarët tanë nga Vala e Kosovës |          | PAKOT PËR SHQIPËRI |          |
|---|----------|--------------------|----------|
| PAKOT                                       | DIASPORA | PAKOT              | SHQIPËRI |
| PAKOT 1                                     | PAKOT 2  | PAKOT 1            | PAKOT 2  |
| PAKOT 3                                     | PAKOT 4  | PAKOT 3            | PAKOT 4  |
| PAKOT 5                                     | PAKOT 6  | PAKOT 5            | PAKOT 6  |
| PAKOT 7                                     | PAKOT 8  | PAKOT 7            | PAKOT 8  |
| PAKOT 9                                     | PAKOT 10 | PAKOT 9            | PAKOT 10 |
| PAKOT 11                                    | PAKOT 12 | PAKOT 11           | PAKOT 12 |
| PAKOT 13                                    | PAKOT 14 | PAKOT 13           | PAKOT 14 |
| PAKOT 15                                    | PAKOT 16 | PAKOT 15           | PAKOT 16 |
| PAKOT 17                                    | PAKOT 18 | PAKOT 17           | PAKOT 18 |
| PAKOT 19                                    | PAKOT 20 | PAKOT 19           | PAKOT 20 |

tëzoni duke u lidhur me cilindo prej operatorëve në Shqipëri. Pushime të këndshme me Vala!", ka thënë Istrefi.



# Miliarderi arab Muhamed Al Barwani shpreh interesim të investojë në 'Trepçë'

Themeluesi i "BM Holding", Muhamed Al Barwani, i cili është një ndër 50 personat më të pasur në botën arabe dhe ka në pronësi shumë biznese në sektorin minerar, në prodhimin dhe përpunimin e naftës e të gazit dhe në prodhimin e jahteve, ka shprehur interesim që të investojë në "Trepçë". Ai të mërkurën është pritur në një takim nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluca



EPOKA E RE  
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Valdrin Lluca, ka pritur të mërkurën në takim themeluesin e "BM Holding", Muhamed Al Barwani, i cili është interesuar që të investojë në sektorin minerar të Kosovës. Al Barwani është një ndër 50 personat më të pasur në botën arabe dhe ka në pronësi shumë biznese në sektorin minerar, në prodhimin dhe përpunimin e naftës e të gazit dhe në prodhimin e jahteve.

Ministri Lluca ka mirëpritur edhe Al Barwani në takim dhe e ka informuar rreth mundësive të investimit në sektorin minerar të vendit tonë, duke i treguar që Kosova është shumë e pasur në plumb, zink, krom,

boksite dhe nikel. Po ashtu, Al Barwanit i janë prezantuar edhe 11 zonat me interes të veçantë minerar dhe miniera e "Trepçës". "Miniera e 'Trepçës' ka 88 minerale të ndryshme dhe është miniera më e pasur në Evropë me plumb dhe zink. Së fundmi, kjo ndërmarrje ka kaluar si shoqëri aksionare dhe tani më është hapur për investime të huaja. Me investime në teknologji do të mund të shfrytëzoheshin edhe më shumë pasuritë e kësaj miniere", ka thënë Lluca.

Muhamed Al Barwani gjithashtu u interesua edhe për sektorin e teknologjisë informative, ku ministri Lluca e ka njoftuar se Kosova është prej vendeve lidere në Evropë për përdorimin e internetit, ku 95 për qind e shtëpive kanë internet me shpejtësi të lartë dhe që,

përmes projektit të ekonomisë digjitale të financuar nga Banka Botërore, pas tre vjetëve Kosova do ta mbulojë tërë territorin e saj me fibër optik.

Muhamed Al Barwani ka theksuar se së shpejti do ta vizitojë Kosovën prapë që t'i shohë për së afërmi potencialet që ofron sektori minerar i vendit. Në

fund, ministri Lluca i ka dhuruar Al Barwanit librin e kristaleve dhe mineraleve të Kosovës si shenjë kujtimi për vizitën në Kosovë.

## Lansohet kampanja 'Vende të shëndetshme pune...'



PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Zyra e BE-së në Kosovë të mërkurën kanë lansuar kampanjën "Vende të shëndetshme pune - menaxhimi i substancave të rrezikshme". Ministri i Punës dhe

Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se kjo fushatë shënon një përpjekje të përbashkët për avancim të sigurisë dhe shëndetit në punë, të kushteve të punës, përfshirë aspekte të tjera sociale, mjedisore e shëndetësore. "Qeveria e vendit, përkatësisht Ministria e

Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka orientuar të gjitha përpjekjet për avancim të të drejtave të punëtorëve, ofrim të mbrojtjes më të mirë sociale, ngritjes së nivelit të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Vitin e kaluar, në kuadër të objektivave tona për avancim të të drejtave

të punëtorëve dhe përmbushjes së obligimeve nga agenda evropiane, ne në MPMS i kemi hyrë reformës së thellë të fushës së marrëdhënies së punës", ka thënë ministri Reçica.

Ai ka shtuar se përpjekjet e Ministrisë së Punës dhe

Mirëqenies Sociale që punëtorët të gëzojnë të drejta të garantuara dhe kushte dinjitoze pune, të njëjtoja me bashkëkohanikët e tyre evropianë, si dhe siguri e shëndet në vendin e punës, do të vazhdojnë edhe më tej, me ritëm edhe më të shtuar.



## Gjilani inauguron sistemin e adresave, 1 923 tabela emërtuese janë vendosur në rrugë dhe sheshe

**GJILAN, 19 QERSHOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me Helge Onsrud nga Autoriteti Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi, zëvendësministri i Mjedisit, Gjergj Beka dhe kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, kanë inauguruar të mërkurën sistemin e adresave, pasi tashmë janë vendosur 19 223 tabela emërtuese në rrugë dhe sheshe. "Ne jemi bërë me adresa. Nuk i kemi më tri adresa siç ka ndodhur deri tash, sepse qytetarët i kanë përdorur të vjetrat, disa të pasluftës e disa

adresa të ish-strukturave. Me konsensus, Kuvendi Komunal i ka miratuar këto adresa, pa dallim partiak, etnik a grupor. Gabimet teknike dhe gabimet e tjera, një komision i veçantë për shqyrtim të ankesave do të merret dhe do t'i rekomandojë Kuvendit Komunal për përmirësim. Nga 1 923 tabela që janë vendosur, ankesa me shkrim janë rreth 50, ndërsa pritet të deponohen mbi 150 ankesa. Ky është investim kapital dhe faleminderit për mbështetjen shtetit të Norvegjisë", ka thënë kryetari i Gjilanit, Lutfi

Haziri. Ai ka kërkuar nga institucionet publike si Hidromorava, Ecohigjiena, KEDS etj., që tash e tutje t'i përdorin për faturim adresat e reja.

Helge Onsrud nga Autoriteti Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi, pasi ka falënderuar kryetarin Haziri për bashkëpunimin në projektin e sistemit të adresave, ka thënë se beson që secili qytetar i Komunës së Gjilanit dhe secili institucion do të ketë mundësi t'i shijojë përfitimet prej një adrese unike si për ofrimin e shërbimeve, ashtu edhe për pranimin e tyre.



## Ministria e Infrastrukturës rregullon mbrojtëset në rrugën nacionale Prishtinë - Pejë

**PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER)** - Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve që janë në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit po punohet për zëvendësimin e pahive elastike (mbrojtëset e metala) të dëmtuara apo të larguara nga qytetarët. Aktualisht po punohet në rrugën nacionale N9, Prishtinë - Pejë dhe në kycjet e autostradave.

Ndërsa puna do të vazhdojë edhe në disa vende të Kosovës, prandaj kërkohet kujdes i ngasësve nga prania e punëtorëve dhe makinerisë. Qëllimi kryesor i MIT-së është që të ofrojë rrugë cilësore dhe të sigurt, prandaj presim mbështetjen e të gjithë qytetarëve që ta japin kontributin e tyre duke mos e dëmtuar pronën publike.



## Qeveria u premtonte fermerëve të Ferizajt se kërkesa e tyre do të trajtohet

**Prishtinë, 19 qershor (ER)** - Kryeministri Ramush Haradinaj ka bashkëbiseduar me fermerët e Ferizajt që protestuan të mërkurën para qeverisë së vendit për kompensimin e dëmeve natyrore në kulturat e tyre. Kryeministri ka bërë me dije se qeveria në

vazhdimësi është munduar t'i shqyrtojë dhe akomodojë kërkesat e fermerëve dhe se edhe kërkesa e tyre do të marrë trajtim. "Shprehja nevojën e krijimit të një sistemi shtetëror për kompensimin e dëmeve, nismë kjo e iniciuar vitin e kaluar në ekzekutiv dhe

e cila nuk është trajtuar asnjëherë më parë. Krijimi i një baze ligjore për përkrahjen e fermerëve edhe në këtë drejtim është nevojë e pashmangshme dhe ne do të angazhohemi për këtë aspekt", ka thënë Haradinaj pas takimit me fermerët e Ferizajt.

## Dëmet bujqësore në Nepërbisht të Suharekës janë të shumta

Si pasojë e të reshurave të shiut dhe breshrit, në fshatin Nepërbisht të Komunës së Suharekës janë shkaktuar dëme të mëdha në tokat bujqësore

**SUHAREKË, 19 QERSHOR (ER)** - Si pasojë e të reshurave të shiut dhe breshrit, në fshatin Nepërbisht të Komunës së Suharekës janë shkaktuar dëme të mëdha në tokat bujqësore. Kështu ka bërë me dije kryetari i kësaj komune, Bali Muharremaj. Ai ka thënë se janë duke u përpjekur që ta analizojnë

gjendjen në terren, më pas t'i dalin në ndihmë banorëve aty. "Në Nepërbisht dëmet janë të shumta në bujqësi si rezultat i rënies së breshrit. Ne po përpiqemi që së pari ta analizojmë gjendjen në terren, më pas t'i shohim mundësitë për t'u dalë në ndihmë", ka deklaruar kryetari Muharremaj.





# KËMBËT DHE GISHTI I DIKTATORËVE



**Bardhyl MAHMUTI**

Logjika diktatoriale, pa marrë parasysh se me çfarë "kostumi" vishet, bazohet në stereotipa të ngjashëm. Si në "Hapat gjigantë" të Stalinit, në "Kërcimin e madh përpara" të Maos ashtu edhe në 100 hapat e Nikolla Gruevskit ambiciet lidhen për këmbësh. Situata aktuale që kalon populli shqiptar në Maqedoni më shtyn të sjell për lexuesin disa çaste nga Kina diktatoriale.

Programi i "rilindjes" komuniste kineze "Kërcimi i madh përpara" i periudhës 1958-1962 solli dëme të mëdha si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Eksperimenti i programeve që lidhen për këmbësh, i lidhën zorrët e popullit kinez. Për shkak të varfërisë së madhe, nga mungesa e ushqim-

it vdiqën miliona njerëz. Njohësit e mirë të kësaj periudhe të historisë kineze sjellin shifra që shkojnë nga 15-38 milionë njerëz që vdiqën nga pasojat e urisë gjatë këtij eksperimentimi.

Varfëria e madhe që kaploi popullsinë, padrejtësitë që bëheshin në çdo pore të jetës politike, ekonomike dhe kulturore, proceset e montuara gjyqësore janë faktorët që ndikuan që populli ta humbasë besimin në "qeverinë popullore".

Kjo revoltë do të marrë përmasa të mëdha në vitin 1966, revoltë që u shpreh me manifestime, në radhë të parë nga rinia studentore, më pas nga shtresa të gjëra popullore. Kur manifestuesit iu drejtuan ndërtesave të "qeverisë popullore", MaoCe Dungu, me dinakëri të paparë në historinë politike, doli nga selia e partisë, iu bashkua manifestuesve dhe drejtoi gishtin drejt ndërtesave të qeverisë: Ata janë fajtorët kryesorë për gjendjen e mjerueshme!

Manifestuesit, të entuziazmuar nga prania e liderit partiak në mesin e tyre, harruan përgjegjësitë e liderit. Iu vërsulën të gjithë atyre që kishin kritikuar Maon për Projektin

"Kërcimi i madh përpara". Spastrime në qeveri, në parti, në institucionet arsimore, në institucionet kulturore... Filloi "Revolucioni kulturor".

Për t'i dhënë përgjigje urisë së madhe, gjatë "Revolucionit kulturor" u lejua kanibalizmi! Në bazë të shkrimtarit të njohur kinez Zheng Ji, vetëm në provincën Shanxi u vranë dhe u hëngrën mbi 10 000 persona, ndërsa në provincën Guangxi rreth 100 000 persona.

Pjesa dërrmuese e tyre ishin intelektualë dhe shkencëtarë të fushave të ndryshme. Krahas përndjekjes së intelektualëve dhe të shkencëtarëve, objekt i shkatërrimit të "Revolucionit kulturor" ishte kultura tibetase. Për një periudhë shumë të shkurtër u shkatërruan tërësisht apo pjesërisht mbi 6 000 tempuj dhe manastire në Tibet.

Eliminimi i intelektualëve dhe shkencëtarëve i ka detyruar historianët dhe analistët e ndryshëm politikë të përpiqen t'i japin përgjigje urrejtjes së Maos ndaj kësaj kategorie shoqërore, që në shoqëritë jodiktoriale janë motor i përparimit shoqëror.

Shumica e analistëve mbështesin shpjegimin e kësaj urrejtje

të Maos ndaj intelektualëve dhe shkencëtarëve me dështimet e veta që t'i përfundojë studimet universitare. Ai përfundoi vetëm shkollën pedagogjike normale dhe me këtë përgatitje shkollore ai gjeti një punë si bibliotekist.

Një problem tjetër i Maos, që theksojnë analistët, lidhet me të folmen e tij. Ai përdorte një dialekt të krahinës së tij (dialektin xing) dhe asnjëherë nuk arriti ta mësojë gjuhën standarde kineze (putonghua). Për shkak të kësaj paaftësi që ta flasë gjuhën standarde kineze, Mao do të jetë shpesh objekt talljeje nga intelektualët që frekuentonin bibliotekën ku punonte.

Një ndër veprimet e para të "Revolucionit Kulturor" të Maos ishte spastrimi i BEIDA-së (Universitetit të Pekinit) nga intelektualët dhe shkencëtarët e dëshmuar.

Zëvendësimi i profesorëve me renome me asistentë dhe studentë të padiplomuar përbën vetëm një segment të programeve që "lidhen për këmbësh".

Mund të zgjatemi në këtë shkrim me argumente të panumërta për logjikën diktoriale që "lidhi zorrët" e popullit nga varfëria.

Në Maqedoni, "Rilindja maqedonase në 100 hapa" shkaktoi varfëri të skajshme të popullsisë në përgjithësi dhe të shqiptarëve në veçanti. Edhe pse kanibalizmi nuk është legalizuar, jemi duke "e hëngër njëri-tjetrin"; Shkatërrimi i kulturës dhe identitetit shqiptar përbën vijën politike të institucioneve shtetërore: shpronësime, shkatërrime monumentesh, humbje gjurmësh arkeologjike, burgosje, tortura, gjykime, plagosje, vrasje.

"100 hapat" e kësaj rilindje maqedonase paraqesin çizmen e okupatorit: që shkel mbi kurriz të popullit shqiptar, mbi kulturën dhe identitetin tonë, mbi dinjitetin dhe jetën tonë, mbi të tashmen dhe të ardhmen e popullit shqiptar në trojet e veta historike.

Të shpresojmë që në protestat që mund të shpërthejnë një ditë nuk do të shohim ndonjë lider partiak që ka qenë me rotacion në institucionet qeverisëse, t'u bashkohet manifestuesve dhe ta drejtojë gishtin drejt ndërtesave të qeverisë: Ata janë fajtorët kryesorë për gjendjen e mjerueshme të popullit shqiptar!

(Ky shkrim është shkruar më 23 prill 2010)

## REGRESI NË KOSOVË KA HISTORI MË TË GJATË SESA NJË MANDAT



**Jakup KRASNIQI**

Kur njeriu dëgjon dhe lexon lajme në mediet tona, lajmet e prodhuara nga politikanët, se "BE-ja po e trajton ndryshe Kosovën" apo "kjo qeveri po shënon vetëm regres", edhe po deshe të heshtësh, nuk mundesh.

Pse nuk mundesh?

Nuk mund të heshtësh se problemet në Kosovë nuk na i ka krijuar BE-ja, por na i ka krijuar

politika e njerëzve shpirtngushtë që nuk kanë vizion dhe dije për ta drejtuar kombin e shtetin në drejtimin e duhur.

Sigurisht edhe kjo qeverisje nuk është e duhura, por as ato parapraket nuk kanë qeverisur gjë më mirë. Qeveritë e kaluara na kanë sjellë në këtë gjendje, kjo e sotmja e ka vazhduar të njëjtin mentalitet të të qeverisurit dhe po vazhdon ta

korrrë atë që ia kishte mbjellë pararendësja.

Çështja është se problemet e grumbulluara ndër vite nuk zgjidhen me kritika ndaj të tjerëve. Problemet tona politike zgjidhen me një vizion të qartë të cilin nuk e kemi as të kornizuar. Gjithashtu, "regresi në qeverisje" nuk zgjidhet me konferenca shtypi, por me program të mirë qeverisës, sigur-

isht jo me programet e qeverive të shkuara, mbase as me këtë të qeverisë së sotshme.

Eh sikur ta kishim një program qeverisës, së paku të skicuar mirë e me përmbajtje shpresëdhënëse për qytetarët shpresëthyer!

A diçka e tillë nuk po shihet në horizontet tona politike.

Të shpresojmë se politika jonë do të kthjelljet një ditë!

## Haradinaj bën homazhe te shtatorja e Hasan Prishtinës në Vushtrri

VUSHTRRI, 19 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të mërkurën ka bërë homazhe te shtatorja e patriotit shqiptar Hasan Prishtina, në qytetin e Vushtrrisë, e cila është përruar në sheshin që mban emrin e tij, në shënimin e 20-vjetorit të çlirimit të kësaj komune. Duke vlerësuar lart

figurën e veprimtarit të palodhur të çështjes kombëtare, Hasan Prishtina, kryeministri Haradinaj tha se nderojnë njërin nga themeluesit e shtetit shqiptar, i cili jetën, pasurinë dhe intelektin e vet e shkriu për lirinë e popullit shqiptar. "Hasan Prishtina është shembulli që duhet ndjekur nga të

gjithë se si duhet ta duam dhe ndërtojmë vendin tonë. Përherë falënderues për rolin historik të themeluesit të shtetit shqiptar", ka thënë kryeministri Haradinaj gjatë homazheve, që bashkë me kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, bëri te shtatorja e Hasan Prishtinës.





## Kimi i kërkoi Trumpit statusin e fuqisë bërthamore

PHENIAN, 19 QERSHOR - Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, u tha zyrtarëve të lartë ushtarakë për takimin e dytë në Hanoi me presidentin amerikan, Donald Trump, se qëllimi i takimit ishte për t'i rrëmby-

er këtë të fundit statusin e shtetit si fuqi bërthamore.

Ky pretendim është raportuar nga "Zëri i Amerikës" falë rrjedhjes së dokumenteve mbi politikën kryesore të Partisë koreano-veriore të Punëtorëve,

dokumente që iu bërthamës në ditura nëpunësve civilë dhe ushtarakë të Veriut. Nga tekstet, autenticiteti i të cilave nuk ishte konfirmuar ende nga Seuli, del se ShBA-ja synonte eliminimin e armëve bërthamore koreane-

veriore. "Cilido qoftë rezultati i negociatave, ato do ta shënojnë hapin e parë në përpjekjet tona për ta forcuar statusin e kombit me armë bërthamore duke duruar të gjitha llojet e vështirësive", thuhej në këto dokumente.



## Trumpi premtion dëbime masive të imigrantëve të paligjshëm

Presidenti Donald Trump ka paralajmëruar se autoritetet e emigracionit do të kryejnë dëbime masive duke filluar nga java e ardhshme, por që një operacion i tillë do të kërkonte qindra mijëra agjentë dhe personel ligjzbatues, të cilët qysh tani përballen me një vëllim të madh pune

WASHINGTON, 19 QERSHOR - Presidenti Donald Trump, i cili nisi zyrtarisht fushatën për rizgjedhje, thotë se autoritetet amerikane të emigracionit do ta fillojnë deportimin e miliona emigrantëve pa dokumente. Disa analistë pohojnë se kërcënimet e tij nuk janë tjetër përveçse pjesë e retorikës së nxehtë të fushatës, por për miliona njerëz mesazhi i tij është një par-

alajmërim serioz. Duke nisur zyrtarisht fushatën, presidenti Trump u bëri jehonë disa temave të njohura. "Ne besojmë se vendi ynë duhet të jetë vendi i shenjtë për qytetarët që respektojnë ligjin, jo për të huaj kriminelë", tha ai.

Përpara kësaj, ai publikoi një numër komentesh në "Twitter", ku paralajmëronte se autoritetet e emigracionit do të kryejnë

dëbime masive, duke filluar nga java e ardhshme. Një operacion i tillë do të kërkonte qindra, apo mijëra agjentë dhe personel ligjzbatues, të cilët qysh tani përballen me një vëllim të madh pune. Analistët thonë se qeverisë i duhen më shumë mjete dhe njerëz. "Mendoj se gjëja e parë është se qeveria duhet të ketë kapacitetin, aftësinë dhe burimet për ta zbatuar ligjin. Me fjalë të tjera, jepini fund krizës në kufi pastaj sigurohuni që autoritetet të jenë në gjendje ta bëjnë punën në brendësi të vendit", tha Jessica Vaughn nga Qendra për Studimet e Emigracionit.

Momenti kur presidenti e dha

njoftimin ngriti menjëherë pikëpyetje sa i përket qëllimeve të tij. Por kundërshtarët paralajmërojnë se retorika e tij tashmë është provuar se vjen me pasoja. "Mendoj se nuk mund të lejojmë qeverinë federale të bëjë atë që ajo thotë se do të bëjë. Ne pamë se si ata nuk i ndryshuan planet për ndarjen e familjeve në kufi dhe, siç e dini, sado që kjo rezultoi diçka e tmerrshme, nuk i pengoi ata ta zbatonin. Prandaj duhet të besojmë se ata do të përpiqen ta bëjnë edhe këtë", tha ajo.

Avokati i emigracionit Matthew Cameron thotë se një operacion masiv deportimi thjesht nuk është i mundur, por nuk ka

dysim se kjo do të ngjallë frikë në komunitetin e emigrantëve pa dokumente. "Kjo do të thotë që njerëzit nuk do të shkojnë në takimet me mjekun, nuk do të shkojnë të marrin fëmijët nga shkolla, nuk do të shkojnë dot të punojnë, nëse vërtet besojnë se ka mundësi që kjo të ndodhë", tha ai.

Në të njëjtën ditë që kërcënoi për deportime masive, presidenti Trump tha se Shtetet e Bashkuara po përgatiten të nënshkruajnë një marrëveshje me Guatemalën, për të mos lejuar njerëzit nga ky vend i Amerikës Qendrore të largohen për t'u shpëtuar përndjekjeve dhe të vijnë të kërkojnë strehim në ShBA.



Reuters

## Tusk: Shumë shpejt emrat e posteve kryesore në BE

BRUKSEL, 19 QERSHOR - Konsultimet mbi lidhshimin e ri të BE-së kanë treguar se, pavarësisht faktit se ka pikëpamje të ndryshme dhe interesa të ndryshme, ne kemi vullnetin e përbashkët

për ta finalizuar së shpejti këtë proces, deklaroi presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk. "Do t'i vazhdoj konsultimet me udhëheqësit dhe shpresoj se mund të vendosim nesër", shtoi ai.

"Ka një interes të përbashkët për mbylljen e lojës të emërimeve para seancës së parë të Parlamenti Evropian. Për këtë arsye unë do të vazhdoj të konsultohem me udhëheqësit një

nga një deri në fillim të samitit", theksoi Tusk. "Mbetem optimist pasi të gjithë kanë shprehur vendosmërinë e tyre për të konkluduar sa më shpejt", përfundoi Tusk.





## Rob Kardashian i rikthehet palestrës



**R**ob Kardashian ua bëri me dije ndjekësve se i është kthyer palestrës në mënyrë që ta ketë një fizik më të mirë. "Dita e parë,


gjithçka mirë", ka shkruar 32-vjeçari nën një fotografi të postuar në "Twitter". Rob është komentuar disa herë për peshën përgjatë viteve.

## Arrestohet ylli i "Empire"



**A**ktori i njohur Bryshere Gray është arrestuar në Çikago për një vepër lidhur me trafikun. Sipas raportimeve, thuhet se targat që artisti kishte nuk janë përputhur me "Roll Royce" 2014 të cilin ai po e ngiste.

Thuhet se ylli i "Empire" u arrestua për një pagesë regjistrimi për kundërvajtje dhe për ngasjen e një automjeti të pasiguruar. Sipas policisë, 25-vjeçari nuk është në paraburgim, por nuk dihet qartë se kur u lirua.



## Rihanna shkëlqen në paraqitjen e fundit

**K**ëngëtarja dhe biznesmenja e njohur Rihanna ka lansuar koleksionin e fundit të Fenty në Webster të SoHo. Sipas "Daily Mail", Rihanna dukej e mrekul-

lueshme në këtë ngjarje. Ajo pati të veshur një fustan të shkurtër ngjyrë rozë. Gjithashtu, pati flokët bishtaleca të gjatë që i rrinin shumë bukur.

## Daniel Craig rikthehet pas lëndimit që mori në këmbë gjatë xhirimeve

**D**ëmtimi që Daniel Craig mori në muajin maj gjatë xhirimeve të "Bond 25" ishte i rëndë dhe shkaktoi mjaft shqetësim. Por aktori i famshëm duket se e ka marrë veten mjaft mirë dhe është gati t'u kthehet xhirimeve. Një fotografi që ka postuar në llogarinë e vet në "Instagram" tregon për stërvitjet që është duke i bërë në palestër, edhe pse këmbën e ka ende me protezë mbrojtëse.





E rrallë

## Aligatori kafshon makinën e policisë

Policia në Caddo Parish në Luiziana u përball me një aligator gjigant. Ajo u thirr pasi zvarraniku u pa në mes të një autostrade lokale. Ndërkohë që policia po priste për ekspertët e kafshëve të egra në mënyrë që ta largonin nga rruga, aligatori me sa duket kishte uri. Sipas postimeve në rrjetin social "Facebook", shihet se krokodili ka ikur, por jo para se të hajë një copë nga makina e policisë.



FOTO E DITES



Një avion shihet në afërsi të aeroportit në Frankfurt derisa dielli perëndonte. Fotografia është publikuar te "Zëri i Amerikës".

E jashtëzakonshme

## Holanda paguan qytetarët për të shkuar në punë me biçikletë



Holanda ka marrë një epitet kohën e fundit si "shteti numër një i parivalizuar i biçikletave" për arsye se është rritur numri i përdoruesve të biçikletave si mjet transporti. Ka shumë shembuj që tregojnë këtë sepse gjatë rrugëve shihen

shumë biçikleta që shfrytëzohen nga njerëzit për të shkuar në punë dhe kthyer në shtëpi. Holanda ka nisur një iniciativë duke filluar t'i paguajë qytetarët me nga 0.22 centë për kilometër për t'u shmangur ngasjes së automobilave.

## BARSOLETA E DITËS



- Në një maternitet dy të porsalindur po bisedonin:
- Je djalë apo vajzë?
  - Djalë.
  - Ma vërteto.
  - Sapo të shkoj infermierja do ta tregoj.
  - Sapo ik infermierja, vogëlushi tërheq kuvertën dhe i thotë:
  - E shikon, kam çorape të kaltra.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)

### "THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan

Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00

### "X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain

Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

### "MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson

Regjia: F. Gary Gray




Ne ora 22:00

### "M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




#### DASHI

Ju nuk prisni t'ju kthejnë mbrapsht atë që keni dhënë. Dhuroni pa interesa dhe kjo gjë ju bën më të lumtur e më të dashur.



#### DEMI

Jeni tip ambicioz dhe sot do të bëni gjithçka që të dalë fjala juaj në fund. Do të keni durimin që të dëgjoni me vëmendje një bashkëpunëtor.



#### BINJAKËT

Keni pasur disa probleme të vogla në fushën e financave, por sot do të zgjidhet gjithçka si me magji. Falë një këshille do ta rikuperoni kohë.



#### GAFORRJA

Sot do të jetë një nga ato ditët që nuk do ta kujtoni aspak për mirë. Ngërçe dhe probleme në çdo fushë të jetës do t'ju nervozojnë.



#### LUANI

Do të jenë të tjerët që do t'ju tregojnë aftësitë dhe të metat tuaja sot. Keni kërkuar mendim nga persona që nuk janë shumë pranë jush për të qenë më realistë.



#### IRGJËRËSHA

Keni gjetur ekuilibrin e duhur midis dashurisë dhe punës, partnerit dhe kolegëve. E vetmja gjë që duhet ta rregulloni është përkushtimi familjar.



#### PESHORJA

Këqkuptimet në ditën tuaj ju bëjnë t'i çoni mendimet tek një ish-partner që nuk po arrini dot ta harroni. Por jeni mjaft kryelartë për ta pranuar.



#### AKREPI

Rutina dhe përditshmëria ju kanë lodhur shumë dhe doni të gjeni një moment hapësire për t'u arratisur diku.



#### SHIGJETARI

Keni vendosur të bëni një udhëtim për të parë vepra artistike dhe historike dhe nuk do t'ju mërziste aspak qëndrimi dhe shijimi i vetvetes.



#### BRICJAPI

Doni të mbyllni një marrëdhënie sentimentale që është ezauruar, por nuk po gjeni kurajën ta përballoni këtë bisedë me partnerin.



#### UJORI

Do të kalojë pak kohë përpara se ta rigjeni dashurinë në jetën tuaj. Megjithatë, si tipa të lirë që jeni, do të dini të argëtoheni me gjërat e tjera të jetës.



#### PESHQIT

Sot do të keni mjaft të papritura përgjatë ditës. Nga ana sentimentale nuk do të ndiheni mjaft të kompensuar dhe kjo do t'ju mërzisë.



# I çmendën të gjithë! VIP-at e parë që 'u zhveshën' këtë sezon veror



## Pamela Aliaj

Normal që të gjithë mezi presim ditët e verës për t'u shkëputur nga punët dhe përditshmëria e jetës. Plazhet këtë vit janë mbushur plot për shkak të të nxehtit të beftë që përfshiu vendin. Por sigurisht që nuk jemi të vetmit që shijojmë rrezet e diellit të kësaj vere përvëluese. Preferuam që kësaj radhe, temën e "Vip Pages" ta nisim me një kolazh të bukurosheve të famshme të veshura me bikini nëpër vendet ku zgjodhën pushimet këtë vit. Mund të themi se për disa janë fotot e para të publikuara këtë vit për sezonin e verës. Kolazhi nis me këngëtarën bukuroshe Arilena Ara që asnjëherë nuk zhgënjën me pamjen dhe e përfundojmë me Tunën e cila mesa duket i është rikthyer trupit superseksi dhe fotove provokuese të kohëve të vjetra të saj. Gjithashtu kemi përfshirë edhe ato që kanë pësuar ndryshim të dukshëm dhe kanë shfaqur për herë të parë foto me rrobabanje në një posturë plot vetëbesim, dhe po flasim pikërisht për rastin e këngëtares që humbi shumë kile nga ndërhyrjet, Big Mama. Për më tepër shijoni kolazhin e mëposhtëm të disa prej VIP-ave tanë që hapën siparin të bikinit 'hot' për këtë vit.

## Arilena Ara

Këngëtarja Arilena Ara, ka vendosur që të shfaqet e nxehtë nëpër rrjetet sociale. Ajo ka postuar disa foto në bikini, gjë që nuk e bënte shpesh më parë. Këngëtarja ka qenë më shumë aktive me këngë dhe karrierë por dielli i Kalifornisë ka bërë që ajo të shfaqet në bikini. Arilena është parë dje në Palm Springs të SHBA-ve ku është



shfaqur në bikini ngjyrë të zezë dhe rozë. Arilena prej këngës "Nëntori" nuk ka publikuar një hit, por shkuarja e saj në Amerikë do të thotë që ajo është duke synuar një famë ndërkombëtare.

## Adola Dushi

Adola Dushi ka publikuar foto me bikini. Bukuroshja shqiptare, Adrola Dushi është një prej emrave që pëlqehet shumë nga publiku, shkruan lajmi.net. Ajo njihet si person shumë i afërt dhe i thjeshtë, e këtë e ka dëshmuar shumë shpesh. Duke qenë aktive në rrjete sociale ajo publikon shpesh edhe foto nga përdit-

shmëria, e së fundmi ka publikuar një imazh në bikini nga pushimet.

## Big Mama

Big Mama është një këngëtare tejet e pëlqyer dhe e përfolur shqiptare. Ajo që e bëri atë në qendër të medieve dhe të publikut është ndryshimi që ajo bëri në pamje duke i humbur kilogramët e tepërt. E tani Big Mama është tejet aktive edhe në rrjete sociale me postime të panumërta. Ajo se fundmi ka publikuar disa foto nga pushimet në Turqi. E shfaqur nga pishina, Big Mama ka 'shkri' pushuesit me linjat e saj.

## Fjolla Morina

Këngëtarja Fjolla Morina ka vendosur që të pushojë para se të fillojë pushimet e saj. Fjolla Morina e ka filluar këtë verë me projekte të reja por edhe me foto tepër seksi. Të tilla janë edhe fotot e saj të fundit ku Fjolla shihet se është në pushime në bregdet. Këngëtarja, e cila është nënë e dy vajzave, ka treguar se ende është në formë dhe se ka kthyer linjat e saj seksi pas lindjes.

## Rovena Stefa

Këngëtarja Rovena Stefa vijon të ruajë linja perfekte fizike, pavarësisht kalimit të viteve.



Edhe pse i ka mbushur 40 vjeç, Rovena shfaqet me trup të tonifikuar. Kështu këtë të hënë ajo ka publikuar një foto ku shihet me trupore të zezë, duke nxjerrë në pah të pasmet. "Tre muaj palestër, baraz ky njeri. Po pas tre muajve?", shkruan këngëtarja. Kjo foto e saj ka marrë komente të shumta nga ndjekësit, të cilët nuk i kanë kursyer komplimentet.

## Sonila Meço

Sonila Meço është padyshim një prej gazetareve më të arrira profesionalisht dhe për sa i përket formimit të saj në gazetari. Ajo është një prej figurave më të komentuar jo vetëm për fushën të cilës i përket, por edhe për jetën personale. Me sa duket gazetarja ka vendosur të shkëputet nga puna dhe të shijojë ditët e nxehta të verës në pishina. Ajo ka publikuar një foto ku duket pranë të bijës dhe shihet në formë të shkëlqyer fizike. Me xhaketa formale ose jo, duhet të themi që gazetarja është një "class" i vërtetë.

## Tuna Sejdiu

Këngëtarja e njohur, Tuna është mjaft aktive në rrjete sociale ku publikon shpesh momente nga jeta e saj private dhe personale. Së fundmi Tuna ka treguar se e ka shijuar shumë fundjavën që lamë pas. Këngëtarja ka publikuar një video mjaft tërheqëse ku pozon me bikini dhe tregon trupin e hatashëm. Na duhet të themi se video të tilla të Tunës kishte kohë që nuk shihnim. Këngëtarja mban të veshur me një palë bikini të zeza ndërsa të poshtmet janë në formë tangash që i ekspozojnë të pasmet. /gsh.al





# 20 mënyra të reja se si të humbni peshë dhe ta keni trupin gati për plazh

Ekspertja e dietave Juliette Kellow, ka 20 mënyra të reja se si të humbni peshë dhe të formësoni trupin, për pushimet verore në plazh. Dëshironi të keni forma të përkryera, por pa mbajtur ndonjë dietë? Këtë tani mund të bëni nëse zbatoni 20 këshillat e doktoreshës Kellow, e cila ka hulumtuar për mënyrat e lehta nëse dëshironi të jeni një 'top plazh', por të keni trupin ideal.

## 1. Mbushni një pjatë të madhe me drithëra...

Shumicën e kohës, thuhet se duhet të hamë më pak, por sipas një studimi të Penn State University, nëse hamë vetëm drithëra për mëngjes, atëherë, duhet të jetë një sasi më e madhe. Studimi tregon se, nëse sasia e drithërave është më e madhe, ndihmon në humbjen e kalorive, më shumë se një sasi e vogël. Përfitimi në trupin për plazh: Ndryshoni mënyrën e sasisë dhe trupi juaj, do të fillojë të humbë kalori, duke u formësuar në mënyrë më të mirë.

## 2. Por duhet të mbyllni televizionin kur jeni duke ngrënë

Keni mundësi më të mira që të keni trup më të mirë, nëse dëgjoni radion. Një studim i bërë me 6.500 të rritur, ka treguar se derisa ushqehen dhe shikojnë televizionin, nuk i kushtojnë rëndësi ushqimit, duke shtuar kështu shanset për mbipeshë. Përfitimi në trupin për plazh: Mbani një ditar se ç'ka po hani. Për shembull, nëse reduktoni një copë bukë, pak gjalpë dhe mjaltë ju mund të humbni 140 kalori në ditë.

## 3. Bëni përzgjedhje më të mirë të ushqimit

Sipas Universitetit të Cornell, ne zgjedhim ushqimin e parë që e shohim në meny të restorantit, apo në frigorifer. Në një anketë të bërë, 86% kanë zgjedhur frutat kur u janë ofruar së pari, kurse 55% kanë zgjedhur kur i është ofruar në fund. Përfitimi në trupin për plazh: Shikoni përreth dhe shikoni mirë se çfarë mund të keni më të shëndetshëm për të ngrënë, e mos e merrni ushqimin e parë që ju vjen te dora. Nëse e zgjidhni një pjatë me më pak yndyrë, në krahasim me tjetrën që ka shumë yndyrë, mund të evitoni shumë lehtë 300 kalori në ditë.

## 4... dhe vendoseni në tabaka

Sipas të njëjtit universitet, ushqimin duhet të vendosni në tabaka, pasi ata që e mbajnë vetëm pjatën, kanë mundësi të marrin me vete vetëm edhe desertin, e jo sallatën. Në tabaka ka vend më shumë dhe mund të



merrni gjerat e shëndetshme edhe nëse nuk do ti konsumoni. Përfitimi në trupin për plazh: Nëse e ndërtoni desertin që sjellë 400 kalori me sallatën që ju sjellë 30 kalori, dallimi në trupin e juaj, do të jetë ndryshe brenda muajit.

## 5. Merrni probiotik në baza ditore

Femrat që janë dobësuar duke përdorur probiotik, kanë humbur pesë kilogram në 12 javë, dy kilogram më shumë se ato që nuk kanë përdorur, është zbulimi që ka bërë Universiteti i Qubeck në Kanada. Përfitimi në trupin për plazh: Zgjidhni probiotikun e duhur, që bën balancimin e bakteve në zorrë, në krahasim me atë që pretendon se është shumë më i shëndetshëm.

## 6. Hani ushqime më të forta

Të rriturit janë më shumë të prirë, të hanë ushqime të buta, në krahasim me ato të forta, ka zbuluar një hulumtim i Universitetit të Floridës. Mirëpo nëse hamë ushqime të forta, trupi ynë gjatë përtypjes shpenzon rreth 50 kalori, që në baza javore është mbi gjysmë kilogrami. Përfitimi në trupin për plazh: Meqenëse pjesa e belit gjithmonë vihet në pah kur jemi në plazh, zëvendësoni ushqimet e buta, me ato që janë më të forta. Për shembull zgjidhni mishin copë, ndërsa largoni mishin e griërë, e njëjtë veproni kur zgjidhni mes bananes apo mollës, dhe bukës dy herë të pjekur me bukën normale.

## 7. Qëndroni në humor të mirë

Hulumtuesit në Institutin e Delawere, kanë ardhur në përfundim se personat që janë të disponuar kanë më shumë mundësi që të zgjedhin ushqimin e shëndetshëm, ndërsa ata që nuk janë në disponim nuk zgjedhin fare. Përfitimi në trupin për plazh: Nëse hiqni dorë çdo ditë nga një kroasant me xhem, ju keni shpëtuar nga 250 kalori në ditë, që i bie afro gjysmë kilogrami në muaj. Andaj mundohuni të disponoheni

me gjëra të tjera që ju bëjnë të lumtur, si dëgjimi muzikës, shëtitjet në diell apo mahitë me shokë.

## 8. Bëhuni të vëmendshëm me ushqimet e shëndetshme

Një studim i ri, tregon se pothuajse të gjithë të rriturit, sapo e shohin mbishkrimin 'e shëndetshme' më nuk e lexojnë përmbajtjen e ushqimit. Kjo nuk do të thotë se gjithmonë këto ushqime janë të shëndetshme dhe nuk bënë të zgjidhet porcioni më i madh. Përfitimi në trupin për plazh: Gjithmonë shikoni përshkrimin e kalorive, pasi përmbajtja mund të ju mashtrtojë. Më pak yndyrë, për shembull do të thotë më shumë sheqer, andaj më mirë veproni në mënyrën e rregullt.

## 9. Përdorni parfum

Kur nuhasim e erën e mishit, bukës, supës apo çokolletës na shtohet apetiti, në krahasim me aromat tjera siç është ajo e pishës, apo e barit të prerë, që e bënë të kundërtën. Përfitimi në trupin për plazh: Kur nuhasni ushqim, ndizni qirinj aromatik, vendosni parfum në trup dhe në dhomë, apo përdorni mjete higjienike, në mënyrë që të shpërqendroheni nga ushqimi.

## 10. Lëshoni gotën në tavolinë kur e mbushni me verë

Në Universitetin e Ajovës, kanë ardhur në përfundim se nëse e zbrazi verën në gotën që e mbajmë në dorë, e mbushim 12% më shumë, se sa në gotën që është në tavolinë. Njëjtë ndodhë edhe me formën e gotës, pasi gotat e gjata, mjafton të mbushet më pak, në krahasim me gotën rrumbullakët. Përfitimi në trupin për plazh: Vendosni gotën në tavolinë kur e zbrazi verën, pasi me 12% më pakë ju keni evituar 20 kalori për një gotë, që në baza mujore është një gjysmë kilogrami.

## 11. Mendoni sikur çdo ditë të jetë e hënë

Në fillim të javës, gjithmonë jemi më të vëmendshëm dhe kujdesemi që të respektojmë dietën, ndërsa kjo ndodhë në 80% të rasteve. Përfitimi në trupin për plazh: Mbani shënime se sa respektoni mënyrën e të ushqyerit në ditën e parë të javës dhe krahasoni me ditët tjera. Ju mund të evitoni mbi 500 kalori, që është afro dy kilogram në muaj.

## 12. Kujdesuni që të hani perime bishtajore

Studimi i Universitetit të Luizianës,

tregon se personat që hanë perime bishtajore, kanë për dy numra rrobat më të vogla, se sa ata që nuk hanë. Mundësi që të vujanë nga mbipeshë, kanë për 53% më shumë, personat që nuk përdorin perime bishtajore. Përfitimi në trupin për plazh: Vendosni perime bishtajore në sallatë, sepse kanë më pak kalori se misri, djathi apo gjëra të ndryshme të pjekura. Nëse veproni kështu, për 30 ditë, mund të evitoni gjysmë kilogram.

## 13. Reduktoni kripën

Ushqimet që i marrim me vete nga restoranti, si picat apo produktet e pastiqerisë, janë të mbushura me kripë dhe me shumë kalori. Për këtë duhet të kemi kujdes sepse ushqimet me kripë, shkaktojnë shtim në peshe dhe në numrin e veshjes. Përfitimi në trupin për plazh: Hiqni dorë menjëherë nga ushqimet me shumë kripë, e posaçërisht ato që kanë shumë kalori. Në vend se të hani një pako çipsa të kriposura me 260 kalori, merrni shkopinj të shëndetshëm karote, që brenda muajit, t keni gjysmë kilogrami më pak.

## 14. Fokusohuni në drekën që hani

Universiteti i Birmingham, ka ardhur në përfundim se femrat që nuk hanë drekën si duhet, në 30% të

keni të njëjtën shije. Kështu ju mund të hani një pjatë që ka 295 kalori, në krahasim me origjinalin që ka 610 kalori, duke e kursyer kështu vetën nga 215 kalori më shumë. Përfitimi në trupin për plazh: Bëni një eksperiment në kuzhinë. Largoni ushqimet e yndyrshme, duke marrë ushqim të shëndetshme me shumë mëlmesa. Me 215 kalori më pak në çdo shujtë, e keni 'qerasur' vetën me një kilogram më pak në muaj.

## 17. Mos hani si të tjerët – përpos nëse është e shëndetshme

Universiteti i Liverpulit, ka ardhur në përfundim se ne jemi të prirë të zgjedhim ushqimin e njëjtë, sikur shoqëruesit tanë. Fat i mirë nëse kemi dikë që ushqehet shëndetshëm, por nuk ndodhë e njëjta me ata që zgjedhin ushqime me shumë kalori. Përfitimi në trupin për plazh: Mos shikoni se ç'farë po hanë të tjerët. Porositni i pari nëse jeni në një grup, duke u bazuar në ushqimin e shëndetshëm, e është mundësi e mirë që të tjerët të ndjekin shembullin tënd.

## 18. Shoqëroju mi me njerëz truphollë

Nuk po themi se duhet të injoroni njerëzit e plotë, por shoqërimi me njerëz të hollë, ju mundëson që të



rasteve hanë grisini dhe gjëra të tjera më vonë. E kjo do të thotë, 30% më shumë kalori. Përfitimi në trupin për plazh: Ndaleni telefonin, televizionin dhe kompjuterin, e fokusohuni 100% në gjellën që hani. Reduktoni më pas 100% gjërat tjera që hani, në mënyrë që të mos shtoni një kilogram më tepër në muaj.

## 15. Merrni rreze dielli në mëngjes

Njerëzit që i ekspozohen rrezeve të diellit në mëngjes, kanë më shumë përparësi se ata që shfrytëzojnë këtë ngrohësi pasdite, sepse drita e rregullon qarkullimin e gjakut, gjë që ndikon direkt në metabolizëm. Përfitimi në trupin për plazh: Njeriut i mjafton vetëm gjysmë ore diell në ditë, mirëpo sa më shumë diell aq më mirë. Dilni për shëtitje në mëngjes, apo bëni xhiro me biçikletë dhe digni nga 250 kalori për 30 minuta. Kjo ju ndihmon të hiqni nga një kilogram në muaj.

## 16. Vëni mëlmesa në ushqim

Studiuesit në Universitetin e Kolorados, kanë vërtetuar se nëse shtoni mëlmesa si organo, hudhra, qepa apo specia djegës ju mund të zëvendësoni ushqimet me yndyrë, me ushqime të shëndetshme dhe të

arrini më shpejt trupin e dëshiruar për plazh. Nëse shoqërohemi me njerëz të plotë, do të fillojë ju duket normal shtimi në peshë dhe më nuk do të mendoni për humbje peshe. Përfitimi në trupin për plazh: Kaloni më shumë kohë në palestër dhe vende të tjera ku kryhen ushtrime fizike, sepse aty ka më së shumti njerëz me trup të hollë. E në të njëjtën kohë, digni kalori duke ushtruar.

## 19. Bëhuni mbretëreshë e kalorive kur hani jashtë

Shumë dyqane të ushqimit të shpejtë, tashmë kanë edhe përshkrimin se sa kalori përmban pjatën, andaj nëse kujdeseni mirë, mund të kurseni 215 kalori duke porositur ushqime më të lehta. Përfitimi në trupin për plazh: Gjithmonë kujdesuni për kaloritë në ushqime, duke porositur opsionet që kanë më pak.

## 20. Largoni joshjen nga pija

Universiteti i Birminghamit ka ardhur në përfundim se njerëzit që mbajnë dietë, nuk mund ti rezistojnë joshjes nga pija gjatë mbrëmjes. Kjo është një lajm i keq për vijën e trupit, sepse një gotë verë, ka 250 kalori.





# Një jetë në burgjet e vëllezërve

## Historia e sopranos së penguar, Safete Sokoli

E lindur me një talent të spikatur artistik në një familje të pasur, me traditë dhe kulturë, Safete Sokoli mund të kishte qenë një nga soprano shqiptare të pasluftës që do kishte shëtitur Shqipërinë nga një cep në tjetrin, për të dhënë shfaqje e për të marrë duartrokitje. Por jeta e saj, atëherë kur duhet të niste ngjijtjen, mori të tatëpjetën. Safete Sokoli shkeli me këmbë, cepa të Shqipërisë që ndoshta as ua kishte dëgjuar emrin, por për një arsye krejt tjetër: për të vizituar vëllezërit në burgjet ku u ndrynë me radhë. Fillimisht, në vitin 1945, i madhi, Ibrahim, avokati i diplomuar në Beograd, më pas Ramadani, studenti për flaut dhe kompozicion në Firenze, që mbetet etnomuzikologu i parë shqiptar dhe më pas, edhe më i vogli, Hodoja, mësuesi i ri, që doli nga burgu pas 26 vitesh, në 1990...

Një jetë e tërë e kaluar nga një burg në tjetrin, për të parë prapa hekurave të vëllezërit dhe duke u munduar në punë të rënda për të siguruar ushqim për ta, që herës tjetër të mund t'i shihnte prapë. Një jetë e tërë nga një burg në tjetrin, e paburgosur, por e dënuar.

Në vitin 1945, kur dënuan Ibrahimin, i cili pas kthimit nga Beogradi ishte bërë pjesë e elitës intelektuale të Shkodrës dhe anëtar i Lëvizjes së Legalitetit, Safetja ishte vetëm 19 vjeç. Ajo ishte fëmija i shtatë i Jusufit dhe Aishes, që patën 3 djem dhe 6 vajza. Ishte rritur mes bollëkut të një prej familjeve më në zë të Shkodrës, në një shtëpi dykatëshe të shekullit XVII, me shkallë mermeri e guri, me çardak dhe një dhomë të madhe me punime në dru, me oxhak madhështor me motive ?oreale, e pajisur me shandanë e armë argjendi, me orë muri të ardhura nga Azia. Kështu e përshkruan në librin e saj "Dhimbje", Fatbardha Saraçi Mulleti, e cila e ka takuar nga afër Safete Sokolin në vitin 1996, në atë shtëpi, ku ajo jetonte me të vëllanë, Hodon dhe të vetmin gëzim kishin vizitat e studenteve të arkitekturës që vinin për të punuar në atë shtëpi me arkitekturë të veçantë që kish humbur shkëlqimin e dikurshëm, por i ruante gjurmët e madhësisë.

Kur ishte në shkollë të mesme, siç i ka treguar autores së librit, këngëtarja shkodrane, Antoneta Ndokillija, Safetja kishte interpretuar bashkë me të, në operën "Drita". Safete Sokoli, me zë sopranoje, luante rolin e vajzës, Dritës, ndërsa Antoneta, mezzosoprano ishte nëna. Opera me muzikë nga Prof. Antonio Muci dhe libret nga drejtoresha e shkollës "Donika Kastrioti", ku studionin vajzat, Silvia Doria, u

vë në skenën e shkollës në vitin 1941 dhe Safete Sokoli, 15 vjeç, mori vlerësime të shumta për interpretimin dhe zërin e saj të bukur. Subjekti ishte i thjeshtë. Vajza e vogël i humbet nga sytë nënës në pazarin e Shkodrës. Vite më vonë, po në pazar, buzë liqenit, ajo dëgjon një vajzë duke kënduar dhe e njeh nga zëri dhe nënë e bijë takohen të përmalluara. Jeta e Safetes, do të mbushej me ndarje e takime të përmalluara me njerëzit e saj të dashur, duke nisur nga 4 vite më vonë, kur i arrestuan vëllanë e madh. Pas Ibrahimit, në '46-ën, arrestojnë edhe të atin Jusufin, si pjesëmarrës në Lëvizjen e Postribës dhe e dënojnë me dy vjet, si dhe vëllanë, Ramadani, që kishte lënë përgjysmë studimet për të qenë në Shqipëri gjatë luftës, të cilin e dënojnë me 5 vjet për agitacion dhe propagandë dhe pjesëmarrje në Lëvizjen e Postribës. Për Safeten nuk kishte më asnjë mundësi për të bërë karrierë si artiste, madje as për të pasur një punë pa stërmundime që u përputhej dijeve të saj.

I vëllai, Ramadani pasi del nga burgu, megjithë persekutimin e vazhdueshëm, për shkak të përgatitjes së jashtëzakonshme dhe nevojave për muzikantë dhe mësues në institucionet e reja që po krijoheshin, arriti të punonte në sektorin e muzikës, edhe pse jo në nivelet akademike që meritonte, por për Safete Sokolin, ishte e pamundur një ritakim i gëzuar me ëndrrat e saj. Në vitin 1964, kur as prindërit nuk jetonin më, i arrestojnë vëllanë e vogël, Hodon dhe e dënojnë me 25 vjet burg. 25 vjet të tjera burg për Safeten, që do të vazhdonin edhe më gjatë, sepse Hodoja u ridënuar si pjesëmarrës në revoltën e burgut të Spaçit, në vitin 1987.

"I ndoqa vëllezërit nëpër të gjitha kampet e punës, nga lindja në perëndim, në Burrel te kështjella famëkeqe e komunizmit, që kanë hyrë njerëzit e nuk kanë dalë gjallë, në Maliq ku thahej kënetat, në Beden ku hapeshin kanale... Në shumë kampe pune, ku punonin të burgosurit politikë. E vetme përjetova vdekjen e prindërve, që më vdiqën brenda gjashtë muajve, ata i mbyllën sytë përjetë, pa i parë djemtë që i kishin të burgosur. Prindërit vdiqën, por nuk panë tmerrin tjetër, arrestimin e vëllaut të vogël. Përpos dhimbjes u shtua kalvari i vuajtjeve të mia. Që nga viti 1964 Hodon e dënuan 26 (njëzet e gjashtë) vjet burg, u ridënuar në revoltën e Spaçit. E ndoqa vëllaun tem Hodo në kampet famëkeqe, pse jo shfarosës, si: Rrepsi, Burreli, Saranda, Spaçi (që ishte tmerr i tmerreve). Eca e eca tok me



bashkëvuajtëset e tjera shkodrane, si me Luçien Koliqi, motër e Jul Koliqit, ajo shkonte të ndihmonte Dom Mikel Koliqin që i kaloi jeta në burg e në internim (në vitin 1995 u bë kardinali i parë i Shqipërisë i Klerit Katolik). Po kalvari im vazhdoi për shumë dekada. Përpos vuajtjeve shpirtërore ishte puna e lodhshme në bujqësi, punova në të gjitha fermat, si: Oblikë, Dobraq, Qafe – Hardhi, gjithmonë e kërrusur. Por edhe aty më ndihmuan moralisht shumë bashkëvuajtës, në veçanti një prift katolik shkodran, i ditur, i talentuar, me një shpirt madhështor, përherë me fjalë të ëmbla, me zërin e tij të qetë bëhej shëruesi i shpirtit të vuajtur, e ky prift i nderuar ishte Dom Lazër Jubani (i burgosur politik). Pas ca vitesh u helmua

nga dora e sigurimit të shtetit. Ndihesha fare e vetmume. E kalova jetën tuj e pasun shok besnik qenin. Kuptohet njerëzit kishin frikë të na vizitonin, jo më të na ?isnin. Por në të gjithë këtë vetmi, vetëm një shoqe e rinisë, e artit dhe e muzikës, nuk më braktisi dhe tasht që jemi të moshuara, ajo më ndjek, kjo është aktorja shkodrane Antoneta Ndokillija (Fishta)", i ka treguar Safetja, Fatbardha Saraçi Mulleti, e cila e ka ndjekur historinë e jetës së kësaj artisteje të penguar, deri në fund dhe fundi nuk ishte siç duhet të kishte qenë për anëtarët e kësaj familjeje të persekutuar pa mëshirë nga diktatura komuniste.

"Në shkurt të vitit 2003, kulla bujare e veriut, ndërtesa treqind vjeçare u shkrymbua nga zjarri, tasht është gjysmë e djegur dhe

me një oborr të shkretuar, një pamje e trishtë. Pleqëria e bëri të sajën, nën përkujdesjen e të afërmeve mbylli sytë përjetë Safete Sokoli në shkurt 2004, në një ditë me shi shkodranët e përcollën bilbilin e qytetit, që s'u lejua të këndonte. Ajo iku, por mbet pas vepra e saj e madhe, dashuria e pakufi që u dhuroi vëllezërve të saj dhe zëri i saj i ëmbël ruhet në një inçizim nga profesor Ramadan Sokoli, dmth zëri i rinisë së saj jeton, ajo mbet në zemrat tona, një melodi e bukur e pafund... Dy javë pas vdekjes së Safetit, i shkoi pas edhe i vëllai Hodoja...", shkruan Fatbardha në librin "Dhimbje".

Safete Sokoli nuk jetoi si artiste, por u bë motra që çdo spektator do ngrihej në këmbë dhe do e duartrokiste gjatë. / *kujo.al*





## Rashkaj: Kualifikimi në Evropian, i mundshëm

Anel Rashkaj për "Epokën e re" ka shfaqur optimizëm se Kosova mund të kualifikohet në Kampionatin Evropian. "Normalisht se jam i kënaqur me rezultatet e arritura në dy ndeshjet e fundit. Shpresoj të vazhdojmë kështu edhe në ndeshjet e radhës. Kemi gjasa për kualifikim në Evropian", ka thënë Rashkaj

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Mesfushori i rikthyer pas një kohe të gjatë në Përfaqësuesen e Kosovës në futboll, Anel Rashkaj, ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se katër pikët e fituara në dy ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2020" ndaj Malit të Zi dhe Bullgarisë janë rezultate pozitive për "Dardanët". Sipas mesfushorit Rashkaj, Kosova ka shanse të mira për kualifikim historik në Kampionatin Evropian.

"Normalisht se jam i kënaqur me rezultatet e arritura në dy ndeshjet e fundit. Shpresoj të vazhdojmë kështu edhe në ndeshjet e radhës. Kemi gjasa për kualifikim në Evropian", ka thënë Rashkaj. Aktualisht Kosova e drejtuar nga trajneri Bernard Challandes është e treta në Grupin A, në vend të dytë është Çekia me pikë të barabarta. 29-vjeçari Anel Rashka u rikthye pas rreth dy vjetësh në Përfaqësuese, kurse u inkadrua në lojë në ndeshjen ndaj Bullgarisë dhe i ka dhënë shumë siguri lojës së

"Dardanëve", të cilët arritën fitore në fund të ndeshjes me rezultat 3-2. Lidhur me të ardhmen e tij në Përfaqësuese, Rashkaj ishte i shkurtër në përgjigje: "Duhet ta mbaj formën dhe të luaj mirë, pastaj vijnë të tjerat". Pas përfundimit të ndeshjeve kualifikuese shumë zëra qarkulluan duke e lidhur Rashkajn me një transferim te skuadra kampione e Kosovës, Feronikeli. Ai e ka përjashtuar rikthimin në futbollin e Kosovës. "Nuk ka asgjë të vërtetë rreth këtij transferimi", ka shtuar anëtari i AFC Eskilstuna.



Rashkaj gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Prishtinën, Halmstadin dhe Sandnesin. Anel Rashkaj ishte kapiteni i parë i Kosovës dhe e udhëhoqi skuadrën në ndeshjen ndaj Haitit, kurse gjasat janë të madha që ai të ftohet edhe në

ndeshjet e ardhshme ku Kosova përballet më 7 shtator me Çekinë në "Fadil Vokrri" dhe më 10 shtator "St. Mary's Stadium", pasi mesfushori i Luzernit, Hekuran Kryeziu, është i lënduar dhe nuk pritet të rikthehet gjatë këtij viti.

## Përurohet stadiumi në Kamenicë

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar sot Komunën e Kamenicës, ku ka marrë pjesë në përirimin e stadiumit të Komunës së Kamenicës. Gjatë kësaj vizite ministri Gashi është pritur nga kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, me të cilin ka nënshkruar dy memorandume bashkëpunimi. Memorandumet e nënshkuara kanë për qëllim mbështetjen financiare të projekteve: "Rregullimi i stadiumit të qytetit të Kamenicës" me 350 mijë euro dhe "Renovimi i Qendrës Rinore në Kamenicë" me 75 mijë euro. "Memorandumet e nënshkuara me Komunën e Kamenicës vijnë si rezultat i kërkesave dhe nevojave të këtij qyteti në fushën e sportit dhe të rinisë dhe, po ashtu, edhe vendosmërisë sonë për t'i mbështetur projektet të cilat kanë për qëllim plotësimin e kushteve për realizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive dhe rinore", u shpreh ministri Gashi, i cili ka shtuar se memorandumet e nënshkuara për stadiumin i cili është përruar sot u bë me qëllim të avancimit të stadiumit në mënyrë që ky stadium të



jetë në shërbim edhe të ekipeve elitare të Kosovës. "Më vjen mirë që më në fund po e përurojmë këtë investim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ka qenë një stërzgjatje e projekteve në komunën tuaj, por ne e kemi një përkushtim të veçantë për këtë lokalitet, për këtë komunë e cila, ndoshta, nuk ka pasur ndonjë përkujdesje të duhur të Ministrisë në të kaluarën, por ne jemi të interesuar që edhe ky projekt që po përfundon sot, por edhe projektet e tjera siç janë Pallati i Sporteve, në të njëjtën kohë edhe Qendra Rinore, të përfundojnë sa më parë që të jenë në shërbim të zhvillimit të aktiviteteve sportive, kulturore dhe rinore", ka thënë ministri Gashi. "Ne jemi duke investuar në të gjitha komunat e Kosovës, por Kamenica e ka një trajtim të

veçantë dhe pjesa e investimeve për periudhën e ardhshme do të jetë shuma rreth 660 mijë euro", ka shtuar ai.

Në takimim me kryetarin e komunës, Qëndron Kastrati, përveç të tjerash, u diskutua edhe për projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore. Konkretisht u fol rreth projektit "Kompleksi Rexhep Malaj", me theks të veçantë u bisduar rreth projektit për kullën e Nuhi Berishës. Pas njoftimit nga ana e kryetarit Kastrati në lidhje me këto projekte, ministri Gashi u tregua i gatshëm për bashkëpunim dhe përkrahje të këtyre projekteve për restaurimin dhe konservimin e këtyre objekteve pasi, siç tha ai, realizimi i tyre ka rëndësi të madhe për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të këtij qyteti. Ndërsa kryetari Kastrati u shpreh i kënaqur me nënshkrimin e memorandumëve të bashkëpunimit. Ai falënderoi ministrin Gashi për mbështetjen e tij, veçanërisht për gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar në të ardhmen për realizimin e projekteve të tjera edhe në fushën e kulturës dhe të trashëgimisë.

## Gjashtë muaj ndalesë për Agim Canën

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryetari i KF Vëllaznimit, Agim Cana, është dënuar nga Komisioni Disiplinor i Shkallës së Parë me gjashtë muaj ndalesë të kryerjes së funksionit zyrtar në klub për të gjitha ndeshjet e organizuara nga Federata e Futbollit e Kosovës. Ky dënim për kryetarin e skuadrës gjakovare vjen si pasojë e asaj se Cana pas përfundimit të ndeshjes përcaktuese për IPKO Superligë mes Vëllaznimit dhe Trepçës '89 ftoi mediet në zhveshtoret e KF Vëllaznimit dhe është prononcuar duke thënë deklarata ofenduese, fyese dhe të pabazuara për futbollin e Kosovës, në prani të futbollistëve dhe të mediave. Një dënim më i

lehtë është ai për sekretarin e KF Vëllaznimit, Blerim Vula, i cili nuk ka të drejtë të ushtrojë asnjë funksion në klub për tre muaj. Dënimi për këtë të fundit erdhi për shkak se Vula pas përfundimit të ndeshjes së barazhit është futur në fushë, duke ofenduar dhe fyer gjyqtarët e takimit dhe drejtuesit e FFK-së. Ndërkohë skuadra e Vëllaznimit dënohet me 1 000 euro. Komisioni Disiplinor e ka dënuar edhe skuadrën e Gjilanit me 1 000 euro. Skuadra nga Anamorava dënohet për shkak se tifozët e saj në ndeshjen e barazhit ndaj Besës së Pejës në kor kanë fyer ekipin kundërshtar dhe lojtarin Alban Tasuni.



## Matthausi: Kosova mund të kualifikohet në Evropian

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Legjenda e futbollit gjerman, Lothar Mathaus, në Prishtinë ka mbajtur një konferencë për shtyp, ku ka folur edhe për shanset e kombëtares së Kosovës në grupin e saj kualifikues të "Euro 2020", pastaj

ka vizituar stadiumin "Fadil Vokrri", ku është takuar me lojtarë moshash të FC Prishtinës. Ish-futbollisti i shquar i kombëtares së Gjermanisë dhe Bayern Munichut u prit në kryeqytetin e Kosovës nga drejtuesit e

"Teleperformance Deutschland" dhe tifozë të tij. Gjatë kësaj vizite ai iu dha zemër "dardanëve" për vijimin e fushatës eliminatorie: "Kosova ka luajtur mirë në ndeshjet e deritanishme në grup. Me Anglinë do ta ketë vështirë. Ju

përgëzoj për skuadrën që keni formuar. Lojtarët besojnë shumë në njëri-tjetrin. Me Çekinë dhe Anglinë do të merrni më pak pikë se në ndeshjet e deritanishme, por keni mundësi të kualifikoheni në Evropian".





## Muqolli: Kemi synime të mëdha në Botëror

Përfaqësuesja U21 e Kosovës në hendboll po vazhdon përgatitjet për kampionatin botëror që mbahet në Spanjë prej 16 deri më 28 korrik. Kosova po e zhvillon fazën e parë përgatitore në Banjë të Pejës. Kapiteni i kësaj grupmoshe, Jon Muqolli, ka thënë se vizioni dhe synimi për botëror është i qartë. "Ekipi

është pothuajse i kompletuar dhe me vizion e synim të qartë para Kampionatit Botëror që është një arritje shumë e madhe për ne. Do të garojmë me ekipet më të spikatura në botë, ndërsa është dashur mund dhe sakrificë për të arritur në këtë pikë. Jemi përfaqësues e re, por me zemër të madhe. Unë si kapiten në

emër të lojtarëve premtoj angazhim maksimal në përgatitje e në ndeshje, edhe pse do të kemi punë me superfuqi të hendbollit. Do ta japim maksimumin që të paraqitemi sa më mirë dhe ta prezantojmë Kosovën si shtet që ka të ardhme të ndritur në hendboll dhe jo vetëm", ka thënë Muqolli.



## Gjakova: Synoj podiumin në 'Minsk 2019'

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Falë Nora Gjakovës, Kosova numëron një medalje në Lojërat Evropiane "Baku 2015". Xhuidistja nga Peja ia solli të bronzën Kosovës në kategorinë deri në 57 kilogramë. Medalja e fituar në Baku e ndryshoi për të mirë Norën. Medaljet e saj nuk u ndalën nga viti në vit, kurse suksesin më të madh e arriti vitin e kaluar, duke u bërë kampione e Evropës, ndërsa për vitin 2018 u shpall sportistja më e mirë e Kosovës. Nga podiumi i Bakus, Nora synon ta pushtojë majën e podiumit të Minskut. Nora flet në intervistën për Komitetin Olimpik të Kosovës.



Si i kujtoni Lojërat Evropiane "Baku 2015"?

**Gjakova:** Lojërat Evropiane "Baku 2015" kanë qenë shumë të veçanta, pjesëmarrja e Kosovës për herë të parë në një garë multisportive ka qenë përvojë ndryshe prej garave të tjera, prandaj edhe e kujtoj që kam pasur shumë emocione para paraqitjes. Kam kujtime shumë të mira, sepse e kam fituar medaljen e parë në një nivel të tillë për seniore.

A e ka vendin e veçantë në sirtarin tuaj kjo medalje?

**Gjakova:** Medalja e Lojërave Evropiane është prej medaljeve me të cilat krenohem më së shumti. Me këtë medalje e kam

siguruar pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë "Rio 2016".

*Çfarë ka ndryshuar te Nora Gjakova prej fitimit të medaljes së bronzit në "Baku 2015" e deri në "Minsk 2019"?*

**Gjakova:** Pas medaljes së Bakus unë kam ndryshuar shumë sa i përket xhudos dhe synimeve të mia. Jam përkushtuar 100 për qind për t'u ngritur sa më shumë dhe kam punuar vazhdimisht. Pas Lojërave Evropiane kam fituar çdo vit medalje në kampionate evropiane për seniore.

*Përgatitjet për "Minsk 2019"?*

**Gjakova:** Përgatitjet kanë shkuar

shumë mirë. Jam munduar ta jap maksimumin në çdo stërvitje. Shpresoj që kjo punë të më shpërblehet.


*Si kampione e Evropës vitin e kaluar, a është synimi i Norës për ta mbrojtur këtë titull edhe në "Minsk 2019", pasi Lojërat Evropiane vlejné edhe si Kampionat Evropian?*

**Gjakova:** Duke qenë kampione evropiane e vitit të kaluar, synimi im është medalja e artë, por në një garë të tillë e rëndësishme është me qenë në podium, pavarësisht prej ngjyrës së medaljes dhe dëshirës për të artën.

## Vetteli në Francë kërkon hakmarrje

PARIS, 19 QERSHOR - Pas polemikave në garën e fundit të zhvilluar në Kanada, ku Sebastian Vettel u penalizua me 5 sekonda dhe humbi vendin e parë, te Ferrari dëshira për hakmarrje është e madhe. "Dëshira për të fituar është jashtëzakonisht e madhe. Garojmë në Francë, në një pistë që na përshatatet, por duhet të punojmë shumë gjatë fundjavës për të qenë gatë në garë. Ka disa pjesë të gjata dhe kthesa të shpejta që mund të na ndihmojnë", ka thënë Vetteli.

Piloti gjerman e kërkon me ngulm fitoren e parë sezonale. "Në fakt, një fitore e arrita në Kanada, por ma hoqën padrejtësisht. Gjithsesi, jam gatë të rikon-



firmohem në pistën franceze. Do të jetë një garë ku gomat sërish do të ndikojnë dhe besoj se do të ketë vetëm një ndalesë. Problem mund të jenë kushtet

klimate dhe ta evitoj ndonjë aksident. Vjet gara ime u ndal në xhiron e parë pas një aksidenti. Këtë vit shpresoj të jetë ndryshe", ka deklaruar Vetteli.

### SHKURT

#### Rahoveci e largon Bujar Locin

KB Rahoveci ka bërë me dije se ka ndërprerë marrëveshjen me trajnerin e tyre, Bujar Loci. Klubi në fjalë i ka dhënë një mirënjohje trajnerit Loci, të cilin e falënderon për arritjet e deritanishme me klubin. Loci ishte trajner i KB Rahovecit për një vit e gjysmë, ndërsa ka arritur që klubin ta dërgojë në dy finale, atë të Kupës dhe të Superligës së Kosovës. "Bujar Loci për një vit e gjysmë ka drejtuar skuadrën tonë në një rrugëtim jo të lehtë, deri te arritjet historike të sezonit të kaluar ku zhvilluam dy finale, atë të Kupës dhe të Superligës. Drejtuesit e KB Rahoveci kanë zhvilluar një takim me trajnerin Loci, ndërsa me marrëveshje kanë vendosur që të mos e vazhdojnë më bashkëpunimin. Bordi, skuadra, por edhe i tërë Rahoveci i janë falënderues dhe mirënjohës Locit për kontributin dhe gjithçka çfarë ka bërë për basketbollin në vendin tonë. I dëshirojmë suksese Bujar Locit në rrugëtimin e tij të ardhshëm, ndërsa çastet me të do të mbesin në analet e historisë për skuadrën tonë. Faleminderit, Loci!", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.

#### Unitedi pas Hysajt

Pas Interit, Atletico Madridit dhe Juventusit, një tjetër klub gjigant ka dalë në skenë për shërbimet e mbrojtësit të Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj. Bëhet fjalë për anglezët e Manchester Unitedit. Sipas "Sky Sports Italia", drejtuesit e "dajve të kuq" kanë kontaktuar ata të Napolit, për ta shprehur interesimin e tyre rreth transferimit të Hysajt. Unitedi është duke kërkuar një mbrojtës anësor, i cili mund të luajë në të dy krahët si zëvendësues i Ashley Young. Veterani anglez luajti edhe si mbrojtës i kraut të majtë dhe të djathtë gjatë sezonit të kaluar. Ky fakt ka bërë që shqiptari 25-vjeçar të jetë nën radarin e drejtuesve të klubit anglez. Napoli kërkon 25 milionë euro për ta lënë të lirë Hysajn, ndërkohë që palët pritet të nisin bisedimet në ditët në vijim.

#### Hummelsi rikthehet te Dortmundi

Mbrojtësi Mats Hummels edhe zyrtarisht do të jetë pjesë e Borussia Dortmundit në edicionin e ri futbolistik. Fillimisht mediet në Gjermani raportuan se marrëveshja është arritur dhe Hummelsi rikthehet në Dortmund pas tre vjetëve të kaluara në Bayern Munchen, kurse më pas edhe dy klubet përkatëse e konfirmuan një gjë të tillë. Shifra që do të transferohet do të jetë 38 milionë euro me bonuse. Gjatë kësaj kohe në "Alianz Arena", 30-vjeçari është paraqitur 74 ndeshje dhe ka shënuar tri gola.

#### Lampardi do të jetë trajner i ri i Chelseat

Chelsea ka vendosur më në fund për trajnerin e ri dhe zyrtarizimi duket çështje orësh. Në krye të bankinës së bluve do të vijë Frank Lampard. Legjenda e londinezve ishte përfolur si favoriti kryesor dhe, me sa duket, diçka e tillë është vërtetuar. Sipas medieve, gjithçka është mbyllur dhe Lampard do të firmosë një kontratë trevjeçare me Chelsean. Kështu, Lampard rikthehet te Chelsea, aty ku u shndërrua në legjendë si lojtar. Sezonin e fundit ish-mesfushori drejtoi Derbyn, me të cilin arriti deri në finalen e "play-off"-it për t'u ngjitur në Premierë Ligë, por u mposht nga Aston Villa.

#### Merret vendimi për Platinin

Arrestimi i Michel Platinit një ditë më parë bëri bujë të madhe me ish-presidentin e UEFA-s që u vu në pranga për shkak të një hetimi për korrupsion. Gjithsesi, nuk ka kaluar shumë dhe francezi është lënë i lirë. Diçka e tillë ka ndodhur pas mesnate dhe Platini ka folur për "France Football", ku ka sqaruar se është marrë në pyetje dhe është përgjigjur shumë qetë, asgjë më shumë. "Zgjati pak si shumë, por ishin shumë pyetje dhe nuk kishte mënyrë tjetër. Më pyetën për Evropianin e vitit 2016, Kupën e Botës që u zhvillua në Rusi dhe atë që do të zhvillohet në Katar në vitin 2022. Gjithashtu, më pyetën edhe për FIFA-n dhe iu përgjigja për çdo gjë shumë qetë", ka thënë Platini.





Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



**Institucioni :** Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall konkurs për këto pozita:

## KONKURS

**Titulli i punës :** Menaxher i Financave  
**Nr.ref.** RN00004815  
**Kategoria funksionale :** Niveli Drejtues  
**Koeficienti :** 9  
**Lloji i pozitës :** I karricrës  
**Orët e punës :** 40 orë në javë  
**Kohëzgjatja e emërimit:** 1 vitë periudha provuese  
**Vendi i punës :** Prishtinë  
**Mbikëqyrës:** Drejtori të Departamentit Financave

**Qëllimi i vendit të punës:** Përgatitja, menaxhimi i buxhetit dhe mbikëqyrja e shpenzimeve financiare për të gjitha njësitë organizative të ARH-ës.

### Detyrat Kryesore

- Menaxhon financat e institucionit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave; 15%
- Menaxhon me stafin përgjegjës për financa dhe në bashkëpunim me udhëheqësin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore; 15%
- Ndihmon udhëheqësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë; 15%
- Siguron, dhe koordinon planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit në përputhje me objektivat e ARH-ës; 15%
- Menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është bazuar në parimet e llogaridhënies; 15%
- Siguron që shpenzimet financiare të jenë në përputhje me planifikimet, rregullat dhe procedurat buxhetore si dhe përgatit raporte periodike mbi shpenzimet buxhetore në bazë të LMFP-së; 10%
- Siguron bashkëpunimin dhe koordinimin me MF-in, Thesarin dhe me auditorin e jashtëm në kryerjen e auditimeve dhe përgatitjen e pasqyrave buxhetore financiare; 10%
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara; 5%

### Shkathësitë e kërkuara

- Diplomë universitare apo të avancuar në drejtimin ekonomik, 5 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri dhe përvojë në fushën e menaxhimit të buxhetit dhe financave;
- Shkathësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Shkathësi kompjuterik të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, internet)

### Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Adresa: Rr. Rrustem Statovci Nr 29 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në ueb faqen zyrtare [www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurroni.

“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosove  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



**Institucija:** Regulativni Autoritet Železnica

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo, br. 03/L - 149 i Uredbe br. 02/2010 o proceduri zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosovo, Regulativni autoritet železnica objavljuje konkurs za ova radna mesta:

## KONKURS

**Naziv radnog mesta:** Finance Manager  
**Ref. br.** RN00004815  
**Funkcionalna kategorija:** Stručni lider  
**Koeficijent :** 9  
**Vrsta pozicije:** Karijerna  
**Radno vreme:** 40 časova nedeljno  
**Trajanje imenovanja:** 1 godina probnog perioda  
**Radno mesto:** Priština  
**Nadzornik:** Direktor Odeljenja za Finansije

**Svrha radnog mesta:** Priprema, upravljanje budžetom i nadzor finansijskih rashoda za sve organizacione jedinice RAŽ.

### Glavne dužnosti

- Ona upravlja finansijama institucije i pomaže supervizoru u postavljanju ciljeva i izradi plana rada za ispunjenje ovih ciljeva.;
- Upravlja osobljem zaduženim za finansije i saradnji sa liderom, organizuje rad kroz dodeljivanje zadataka svojim zavisnim članovima, pruža smernice i prati rad osoblja za pružanje kvalitetnih proizvoda i usluga;
- Pomaže lideru u proceni internih procesa i procedura i preporučuje promjene / poboljšanja kako bi se povećala efikasnost na poslu;
- Obezbeđuje i koordinira planiranje i pripremu budžeta u skladu sa ciljevima RAŽ;
- On upravlja gotovinskim rezervama i osigurava da se interna finansijska kontrola zasniva na principima odgovornosti;
- Obezbeđuje da su finansijski troškovi u skladu sa budžetskim planiranjem, pravilima i procedurama i da priprema periodične izveštaje o budžetskim rashodima u okviru;
- Obezbeđuje saradnju i koordinaciju sa MF, Trezorom i spoljnim revizorom u vršenju revizija i pripremi finansijskih izveštaja o budžetu;
- Vrš redovno ocjenjivanje osoblja pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuku kako bi se osiguralo da se njihove dužnosti postižu prema traženim standardima

### Potrebne veštine

- Univerzitetska diploma, Ekonomski fakultet, 5 godina profesionalnog iskustva
- Znanje i iskustvo u oblasti upravljanja budžetom i finansijama
- Poznavanje važećih zakona i propisa
- Vještina u planiranju komunikacija funkcioniše eventualnu koordinaciju osoblja na administrativnom nivou;
- Istraživačke, analitičke, evaluacijske vještine i formuliranje preporuka i stručnih savjeta;
- Računarske veštine u programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Internet).

### Preuzimanje i dostavljanje aplikacija:

Aplikacije se preuzimaju i dostavljaju u Kancelarijama Regulativnog Autoriteta Železnica, Adresa: Ul. Rrustem Statovci Br. 29 Priština, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Aplikacija se može preuzeti i na službenoj veb stranici [www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja konkursa.

Aplikaciji treba priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koja se zahteva za ovo radno mesto za koje konkurirate.

“Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje svih građana Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.”

“Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe javne uprave na centralnom i lokalnom nivou kao što je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosovo”.

“Aplikacije dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune aplikacije će biti odbijene”. Aplikaciji treba priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i ostalu potrebnu dokumentaciju koja se zahteva za ovo radno mesto za koje konkurirate. Samo kandidati odabrani na užem spisku biće kontaktirani.

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-149, neni 12, paragrafi 4, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë shpall:

**Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"**

**Institucioni:** Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë

**Departamenti:** Departamenti i arsimit të lartë shkencës dhe teknologjisë

**Paga bruto:** 483.34 €

**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar/e për inovacion dhe teknologji (2 vende pune)

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 muaj

**Vendi i punës:** Prishtinë **Datë:** 19.06.2019

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Ndhmon udhëheqësin e divizionit për transfer në kryerjen e detyrave në lëmin e administratës,
2. Ndhmon në procesin e konkursit për mobilitete afatshkurta, pjesmarrje në hulumtime dhe konferenca,
3. Ndhmon në regjistrimin e lëndëve për bursa të doktoratës,
4. Ndhmon në regjistrimin e lëndëve për voucher të inovacionit,
5. Kryen detyra të tjera të caktuara nga udhëheqësi.

**Kualifikimet**

1. Diplomë universitare
2. Një vite përvojë pune

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 7 ditë kalendarike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 26.06.2019.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në uebfaqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rr. "Agim Ramadani" nr. 1 në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije vrši:

**Konkursa za "Sporazum o posebnim uslugama "**

**Institucioni:** Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

**Departamenti:** Departament visokog obrazovanja nauke i tehnologije

**Paga bruto:** 483.34 €

**Naziv radnog mesta:** Službenik/ca za inovacije i tehnologije (2 radna mesta)

**Vreme trajanje ugovora:** 6 meseci

**Radno mesto:** Priština **Datum:** 19.06.2019

**Radni zadaci i odgovornosti:**

1. Pomaže rukovodiocu divizije za transfer u obavljanju zadataka u oblast administracije
2. Pomaže u proces konkurisanja za kratkoročne mobilnosti, učešće u istraživanju i konferencije,
3. Pomaže u registraciji predmeta za stipendije za doktorat,
4. Pomaže u registraciji predmeta za voucher inovacije
5. Obavlja i druge poslove na zahtev rukovodioca.

**Kvalifikacije:**

1. Univerzitetsku diplomu
2. Jednu godinu radnog iskustava

**Uslovi učešće na konkurs:**

Pravo na podnošenje aplikacije imaju svi punoletni građani Republike Kosova koji imaju sposobnost delovanja, da imaju potrebnu školsku spremu i profesionalnu sposobnost za izvršavanje obaveza i ona lica koja imaju fizičku sposobnost koja se zahteva za relevantan položaj.

**Datum završetka konkursa:** Konkurs je otvoren 7 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnoj štampi. Datum zatvaranja konkursa je 26.06.2019.

Kandidati aplikacija ( obrazac za konkurisanje ) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/>, ili u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, kancelariji arhive u kojoj će kasnije popunjene aplikacije predati.

**Uz aplikaciju mora biti priložena:** Kopija lične karte, kopija dokumentacije o kvalifikovanju, kao i ostala dokumentacije potrebna shodno konkursu.

Zahtevi dostavljeni nakon isteka konkursa neće biti primljeni. Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati izabrani na užoj listi biće kontaktirani





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë bën:

**Shpallje të konkursit për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"**

**Institucioni:** Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

**Departamenti:** Arsim parauniversitar  
**Paga bruto:** 423.47 €

**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar/e për arsim privat parauniversitar  
(1 vend pune)

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 muaj

**Vendi i punës:** Prishtinë **Datë:** 19.06.2019

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Hartoni dhe zhvilloni planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Analizon legjislacionin, politikën dhe procedurat lidhur me arsimin privat me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve cilësorë;
- Mbështet licencimin e bartësve të arsimit privat parauniversitar si dhe këshillon mbikëqyrësin lidhur me licencimin ;
- Të mirëmbahet dokumentacioni i institucioneve private, të jenë të kompletuar për secilin institucion;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyri.

**Kualifikimet**

- Diplomë universitare, 1 vit përvojë pune profesionale.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 7 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 26.06.2019.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në ueb faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Adresa: Rr. "Agim Ramadani" nr. 1, në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o Civinij službi Republike Kosova Zakon Br.03/L/149, član 12, stav 4, Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije

**Objavljuje konkurs "Sporazum o posebnim uslugama"**

**Institucija:** Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

**Departamenti:** Preduniverzitetsko obrazovanje

**Plata bruto:** 423.47 €

**Naziv radnog mesta:** Službenik/ca za privatno predunivevzitetsko obrazovanje  
(1 radno mesto)

**Vreme trajanja ugovor:** 6 meseci

**Radno mesto:** Priština **Dat:** 19. 06.2019

**Zadaci i odgovornosti:**

- Sastavlja i razvija plan rada u skladu sa nadzornikom za sprovođenje obaveza utvrđenim na osnovu objektivna jedince i daje preporuke u vezi realizacije ovih objektivna.
- Analizira zakonodavstvo, politiku i procedure u vezi privatno obrazovanje u cilju omogućavanje kvalitetnih usluga i proizvoda.
- Podržava licenciranje nosioce privatnog preduniverzitetskog obrazovanja kao i savetuje nadzornog u vezi licenciranja.
- Održava dokumentaciju privatnih institucija, da bude kompletirana za svaku instituciju.
- Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonom i uredbama koje može opravdano da zatraži nadzorni;

**Kvalifikacije**

- Univerzitetska diploma 1 godina radnog iskustva.
- Poznavanje primenjivog zakona i uredbi u vezi obrazovanje.
- Istraživačke, analitičke, ocenjivačke veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta.
- Sposobnosti za ispunjavanje poslova i obaveza pod pritiskom.
- Veštine rada na kompjuter aplikacije programa (Word, Excel i Power Point, Access, Internet).

**Uslovi za učešće na konkurs**

Pravo na apliciranje imaju svi punoletni državljani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, da imaju potrebno obrazovanje i stručnu sposobnost da obavljaju dužnosti i koji imaju fizičke veštine koje se zahtevaju za određenu poziciju.

**Datum zatvaranje konkursa:** Konkurs je otvoren 7 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnoj štampi. Dat zatvaranje konkursa 26.06.2019

Kandidati aplikacije (obrazac za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/> ili da dobiju u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije Adresi: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, u kancelariji arhive, gde takođe i dostavljaju popunjene aplikacije.

**U prilog aplikacije morate priložiti:** Kopija lične karte, kopija dokumentacije o kvalifikaciji, kao i ostala dokumenta potrebna u skladu sa konkursom.

Zahtevi poslati nakon isteka roka neće se primati. Zbog velikog broja pristiglih prijava kontaktiraće se samo kandidati koji su ušli u uži izbor.





**TrafikuUrban**

## K O N K U R S

**Pozita e punës:** Zyrtar Ligjor (1 pozitë).

**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit, me mundësi vazhdimi.

**Orari i punës:** I plotë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kryen punë ligjore për ndërmarrjen;
- Asiston në përpilimin e rregulloreve dhe akteve tjera të ndërmarrjes;
- Me kërkesë të udhëheqësit përgatitë vendime, shkresa, parashtresa për ndërmarrjen;
- Me kërkesë të udhëheqësit, harton kontrata, marrëveshje dhe memorandume për nevoja të ndërmarrjes;
- Ndhmon sekretarin në ofrimin e këshillave ligjore dhe bën hulumtime ligjore për nevoja të ndërmarrjes;
- Kujdeset për përgatitjen, shtypjen e materialeve të mbledhjeve dhe shpërndarjen e tyre.
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të menaxhmentit dhe komiteteve të tjera në rast nevoje.
- Monitoron dhe koordinon punët e Burimeve Njerëzore;
- Bën rregullimin e dosjeve dhe mban regjistrin e tyre.
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi.
- Kryen edhe detyra dhe obligime të parapara me akte normative të brendshme.
- Për kryerje e detyrave dhe përgjegjësi i përgjigjet Sekretari/Menaxheri i Zyrës Ligjore të ndërmarrjes.

**Përgatitja profesionale**

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, niveli Bachelor apo Master;
- Përvojë punë 3 vjeçare;
- Aftësi shumë të mira të punës me kompjuter;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etik profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

**Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com);

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>);

2. Letër motivuese;

3. Dëshmi mbi shkollimi;

4. Dëshmi mbi përvojën e punës;

5. Kopja e letërnjoftimit;

6. Kandidati së bashku me aplikacionin duhet të dorëzojnë edhe vërtetimin nga gjykata kompetente se i njëjti nuk është nën hetime – jo më të vjetër se 6 muaj.

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com).

Konkursi është i hapur nga data **20.06.2019** dhe përfundon më datë **04.07.2019** në ora 24:00.

Prishtinë, më 19.06.2019

N.P.K "Trafiku Urban" SH.A

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë/ Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 (0) 45 10 11 23

2



## NJOFTIM PËR KONTRATË

(Punë)

RITENDERIM

Procedurë e hapur

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (dhjetor 2016)"

**I** Numërtimi i Prokurimit: BQK 19 032.1 332  
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

**II** LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja:

"Implementimi i zonës interlock në objektin e BQK-së"

**III** VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, 10000 Prishtinë, Rr. "Garibaldi" nr. 33

**IV** INFORMATA ADMINISTRATIVE

IV.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 28.06.2019 ora 14:00 në e-mail adresën [prokurimi@bqk-kos.org](mailto:prokurimi@bqk-kos.org)

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 26.06.2019 ora 14:00

IV.2 Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:

Data: 02.07.2019, ora 14:00

IV.3 Sigurimi i tenderit: N/A

IV.4 Sigurimi i kontratës: Po

IV.5 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 02.07.2019, ora 14:30. Vendi: Auditoriumi i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33

**V** INFORMATA PLOTËSUESE

V.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**VI** ANKESAT

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë BQK-së brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve kalendarikë nga shpallja e njoftimit përkatës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë  
[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

## GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C.1109/18

Gjyqtari Gëzim Shehu në çështjen juridike të paditëses Florije Majed e lindur Gashi nga Prizreni rr, Brigada 125 Lam 3 hyrja 1 banesa nr.9 të cilën me autorizim e përfaqëson Av. Ymer Koro nga Prizreni, kundër të paditurit Fuad Majed nga Prizreni, rr. Brigada 125 Lam 3 banesa nr.9 për shkak të zgjidhjes së martesës dhe ruajtjes së fëmijës së mitur me datë: 31.05.2019 morri këtë

## AKVENDIM

Të paditurit Fuad Majed nga Prizreni tani në adresë të panjohur I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm av. Bestar Kolgeci nga Prizreni. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njofton gjykatën se e ka caktuar kujdestarin. Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetatat e përditshme ditore. Dhe në tabelën e shpalljeve në gjykatë.

Gjyqtari: Gëzim Shehu





**ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A. Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Fumado Ltda. Brazil, Quality
- ★ Intarbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zolal C.JSC Tajikistan, Quality
- ★ ParTex Sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales




# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Sejdi Zeka shpall te pavlefshme Certifikatën e biznesit me nr. NRB: 810010728 me emër te biznesit "Albion" Shpk Likovc.
- ▶ Bahrije Aruqaj shpall te pavlefshme Diplomën e shkollës fillore "Drenica" Polac.
- ▶ Mentor Zeqiri shpall te pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj.
- ▶ Kompania "Ada Group" Sh.a. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: Nrb:70966727 dhe numër fiscal: Nrf.600985420
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



**MEKA HALAL FOOD**

# PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pulë

**cilësi e garantuar**

pa konservues